



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E HARMONIZIMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM
FINANCIAR PUBLIK

DREJTORIA E HARMONIZIMIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Nr 12875/ Prot.

Tiranë, më 17/10 2022

Lënda: Dërgohet Raporti Përfundimtar i Vlerësimit të Jashtëm të Cilësisë

UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS

Adresa: Lagjja 1, Rruga: "Curilave", Durrës

Në vijim të procesit të vlerësimit të veprimtarisë audituese të Sektorit të Auditimit të Brendshëm në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës, si dhe duke Ju falenderuar për bashkëpunimin gjatë vlerësimit të kryer, në zbatim të nenit 24, të ligjit 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", pikës 7.2 të kapitullit VII "Vlerësimi i jashtëm i cilësisë", të Manualit të Auditimit të Brendshëm, të ndryshuar, Metodologjisë së vlerësimit të jashtëm të cilësisë", miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr.22, datë 06.03.2017, bashkëlidhur Ju dërgojmë Raportin Përfundimtar të vlerësimit të jashtëm të cilësisë.

Duke shpresuar se rekomandimet e adresuara do t'i shërbejnë rritjes së cilësisë së veprimtarisë audituese, Ju kujtojmë se Plani i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve i plotësuar, duhet t'i përcillet grupit të vlerësimit jo më vonë se 30 ditë kalendarike nga data e marrjes së Raportit Përfundimtar.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Eros Angjeli





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E HARMONIZIMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM
FINANCIAR PUBLIK
DREJTORIA E HARMONIZIMIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM

RAPORT PËRFUNDIMTAR
VLERËSIMI I JASHTËM I CILËSISË
SEKTORI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM
NË
UNIVERSITETIN “ALEKSANDËR MOISIU” DURRES



Korrik 2022

PËRMBAJTA

I.	PËRBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
II.	HYRJA.....	7
III.	GJETJET DHE KONKLuzionET	9
	• STANDARD ISSPA 1000 - QËLLIMI, AUTORITETI DHE PËRGJEGJËSIA	9
	• STANDARD ISSPA 1100 – PAVARËSIA DHE OBJEKTIVITETI	13
	Monitorimi i progresit të rekomandimeve të vlerësimit të kryer nga Kontrolli i Lartë i Shtetit.....	16
	• STANDARD ISSPA 1200 - AFTËSITË DHE KUJDESI I DUHUR PROFESIONAL	17
	• STANDARD ISSPA 1300 SIGURIMI I CILËSISË DHE PROGRAMI I PËRMIRËSIMIT	19
	• STANDARD ISSPA 2000 - MENAXHIMI I VEPRIMTARISË SË AUDITIMIT TË BRENDSSHËM	21
	• STANDARD 2100 - NATYRA E PUNËS	25
	• STANDARD 2200 - PLANIFIKIMI I ANGAZHIMIT	28
	• STANDARD 2300 - KRYERJA E ANGAZHIMIT	30
	• STANDARD 2400 - KOMUNIKIMI I REZULTATEVE	31
	• STANDARD 2500 - MONITORIMI I PROGRESIT	34
IV.	OPINION I PËRGJITHSHËM	36
	ANEKS 1: METODOLOGJIA	37
	ANEKS 2: BURIMET E INFORMACIONIT	38
	ANEKS 3: LISTA E INTERVISTAVE TË ZHVILLUARA	39

FALENDERIME

Falenderojmë për bashkëpunimin dhe komunikimin korrekt, Rektorin e Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës, Kryetarin e Bordit të Administrimit, Drejtuesin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm dhe audituesit e brendshëm në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës, me të cilët janë zhvilluar intervistat.

Grupi i Vlerësimit

I. PËRBLLEDHJE EKZEKUTIVE

Në këtë Raport subjekt i vlerësimit të jashtëm të cilësisë është veprimtaria e Sektorit të Auditimit të Brendshëm, pjesë e strukturës organizative të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës.

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës (UD), është themeluar në vitin 2006. Në këtë institucion organi më i lartë drejtues akademik është Senati Akademik, autoriteti drejtues akademik është Rektori dhe organi më i lartë drejtues administrativ është Bordi i Administrimit.

Vlerësimi i jashtëm i cilësisë bazohet në nenin 24, të Ligjit Nr.114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, në Kapitullin VII të Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me urdhër të Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016, i ndryshuar, si dhe në “Metodologjinë e vlerësimit të jashtëm të cilësisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik”, miratuar me urdhër të Ministrit të Financave nr.22, datë 06.03.2017.

Grupi i vlerësimit, për realizimin e vlerësimit të jashtëm të cilësisë, në përputhje me bazën ligjore të cituar më sipër, përcaktoi si objektiva:

- Monitorimin dhe vlerësimin e veprimtarisë së Sektorit të Auditimit të Brendshëm, përputhshmërinë me ligjin 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, Manualin e Auditimit të Brendshëm, të ndryshuar, si dhe standardet ndërkombëtare të pranuara;
- Vlerësimin e efektivitetit dhe efikasitetit të këshillave dhe rekomandimeve të adresuara për subjektet e audituara.

Sektori i Auditimit të Brendshëm, subjekt i këtij vlerësimi të jashtëm të cilësisë, është pjesë integrale e strukturës organizative të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës, cili ka përcaktuar misionin dhe vizionin e tij në funksion të qëllimit dhe fushës së përgjegjësisë të përcaktuar në Ligjin nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës, në gjithë veprimtarinë e tij synon në mënyrë të vazhdueshme të arrijë standardet akademike më të larta bashkëkohore kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe të përkrahë aspiratat arsimore dhe arritjet e cilitdo që kërkon të përfitojë nga arsimi i lartë.

MISIONI

Me misionin e tij, Universiteti ka për qëllim: *“nxitjen dhe zhvillimin e të menduarit kritik e analitik, si dhe ndjenjës së përgjegjësisë dhe angazhimit ndaj njeriut, komunitetit, kulturave, ngjarjeve e çështjeve të ndryshme që shqetësojnë individin dhe komunitetin.*

Bazuar në përcaktimet e mësipërme, Sektori i Auditimit të Brendshëm në këtë Universitet, duhet të realizojë shërbimin e auditimit të brendshëm në Rektoratin e Universitetit të Durrësit dhe në gjashtë njësi varësie, për të cilat duhet të vlerësohet funksionimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm. Këto njësi përfaqësojnë:

Fakultetet:

- Fakulteti i Biznesit;
- Fakulteti i Edukimit;

- Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit;p
- Fakulteti i Shkencave Politike-Juridike;
- Fakulteti i Studimeve Profesionale;
- Fakulteti i Studimeve të Integruara me Praktikën.

Gjetjet dhe konkluzionet

Në vlerësimin e jashtëm të cilësisë të Sektorit të Auditimit të Brendshëm në Universitetin e Durrësit, grupi i vlerësimit konstatoi se në veprimtarinë audituese respektohej kuadri rregullator në fuqi, por megjithatë u evidentuan fusha që kërkonin përmirësim në të ardhmen, të cilat janë trajtuar në këtë material.

Nga dokumentacioni i shqyrtuar, grupi i vlerësimit evidentoi gjetjet sa më poshtë:

- Karta e Auditimit të Brendshëm nuk ka përditësuar ndryshimet e miratuara në Manualin e Auditimit të Brendshëm, të ndryshuar.
- Nuk është realizuar vlerësimi i brendshëm i cilësisë dhe nuk ishin vlerësuar indikatorët e matjes së cilësisë së performancës së veprimtarisë audituese, si pjesë e Programit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.
- Programet e auditimit nuk kanë të përcaktuar objektiva specifike për çdo angazhim auditimi, të cilat të pasqyrojnë vlerësimin paraprak të riqeve të veprimtarisë që auditohet.
- Programet e auditimit duhet të përfshijnë drejtimit e auditimit, të cilat përfaqësojnë çështjet e identifikuar për t'u trajtuar në funksion të raportimit të informacionit.
- Programet e auditimit duhet të përfshijnë si drejtim të veçantë vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, nëpërmjet analizimit të pesë komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si drejtim i rëndësishëm për vlerësimin e riskut.
- Raportet e auditimit nuk shprehin opinion të përgjithshëm, të qartë, mbi funksionimin dhe vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe nuk kanë të përcaktuar nivelin e riskut në përfundim të angazhimit të auditimit.

Rekomandimet

Bazuar në gjetjet e konstatimet e trajtuara, në identifikimin e fushave që kërkojnë përmirësim në të ardhmen, janë adresuar rekomandimet e mëposhtme për:

- Përditësimin e Kartës së Auditimit të Brendshëm dhe plotësimin e strukturës së saj me përshkrime sipas kërkesave të MAB, të ndryshuar.
- Zbatimin në mënyrë të vazhdueshme të Programit të Sigurimit të Cilësisë dhe vlerësimin e performancës së NjAB.
- Përcaktimin e objektivave specifike për çdo angazhim auditimi, të cilat të pasqyrojnë vlerësimin paraprak të riqeve të veprimtarisë që auditohet.
- Plotësimin e programit të auditimit me drejtimit e auditimit, të cilat përfaqësojnë çështjet e identifikuar për t'u trajtuar në funksion të raportimit të informacionit.
- Përfshirjen në programin e auditimit të vlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, nëpërmjet analizimit të pesë komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si drejtim i rëndësishëm për vlerësimin e riskut.

- Raportet e hartuara në përfundim të çdo angazhimi duhet të plotësohen me një opinion të përgjithshëm sa më të qartë lidhur me funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, si dhe nivelin e riskut të përcaktuar në përfundim të angazhim auditimit.

Opinion i Përgjithshëm

Grupi i Vlerësimit për përputhshmërinë e veprimtarisë së Sektorit të Auditimit të Brendshëm në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm, të pranuar, bazuar në vlerësimin e kriterëve kryesore (ISPPIA 1100, ISSPIA 1200, ISSPIA 2000, ISSPIA 2200, ISSPIA 2300) dhe dytësore, të grup standardeve të konsideruara shumë të rëndësishme, kur një nga standardet kryesore është vlerësuar me të verdhtë- dhe gjithë standardet kryesore janë vlerësuar me të gjelbër, jep Opinionin e përgjithshëm:

E verdhtë

Veprimtaria e Njesisë së Auditimit të Brendshëm është në përputhje të pjesshme me kuadrin rregullator dhe me standardet ndërkombëtare për praktikën profesionale të auditimit të brendshëm, dhe përmirësimi është i nevojshëm në fushat ku janë adresuar rekomandimet.

II. HYRJA

Në zbatim të “Planit Vjetor i punës së Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm për vitin 2022”, miratuar nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë me shkresë nr.23648 datë 31.12.2021 dhe mbështetur në kërkesat e Standardit 1312 “Vlerësimet e Jashtëme”, objekt i vlerësimit të jashtëm të cilësisë është veprimtaria e Sektorit të Auditimit të Brendshëm (SAB) në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës.

Vlerësimi i jashtëm i cilësisë u mbështet në përputhshmërinë e veprimtarisë së kësaj njësie të auditimit të brendshëm me ligjin nr.114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, aktet nënligjore, të cilat bazohen në standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm, të pranuar, Metodologjinë e vlerësimit të jashtëm të cilësisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr.22 datë 06.03.2017, si dhe në zbatim të Programit të Vlerësimit të Jashtëm të Cilësisë nr.12875/1, datë 01.07.2022

Universiteti i Durrësit për të realizuar këtë mision strategjik, kërkon të ketë një ndikim transformues në shoqëri, përmes inovacionit të vazhdueshëm në arsim, hulumtim, kreativitetin të lartë dhe pjesëmarrjes aktive në zhvillimin social dhe ekonomik të vendit nëpërmjet realizimit të qëllimeve kryesore të bazuar në:

- ✦ Programet universitare mësimore-shkencore të një niveli të përparuar e bashkëkohor teorik, metodik e praktik, të përgatisë profesionalisht specialistë të lartë në fusha që përmbushin nevojat e individëve dhe punëdhënësve duke i përgatitur të diplomuarit për karriera të shumëllojshme në tregun konkurrues të punës në përputhje me kërkesat dhe nevojat e shoqërisë në ndryshim dhe zhvillim;
- ✦ Punën kërkimore-shkencore të nivelit më të përparuar të formojë shkencëtarë të rinj në fushat që mbulon;
- ✦ Programet që kryejnë kualifikime shkencore të personelit akademik në të gjitha fushat e shkencave të mirëfillta teorike dhe në fushat e shkencave të zbatuara dhe metodike-administrative që mbulon;
- ✦ Tërheqjen e specialistëve më të mirë dhe të inkurajojë me të gjitha mënyrat kontributin e tyre, vazhdimisht në rritje, në fushat përkatëse;
- ✦ Kryejnë e studime shkencore për të zhvilluar më tej dijen në profilet shkencore që lëvron;
- ✦ Ofrimin e kualifikimit të vazhdueshëm e bashkëkohor për personelin akademik në fushat që mbulon;
- ✦ Programeve universitare që përgatisin specialistë të profileve të caktuara ose të ngushta për fushat që mbulon ose për fusha të reja që dalin, për t’iu përgjigjur nevojave kombëtare e rajonale;
- ✦ Studimet universitare që zhvillohen në përputhje me rregullat dhe parimet e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë. Diplomat ofrohen në dy gjuhë (shqip dhe anglisht) dhe vlerësimi shprehet sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS) dhe Sistemit Amerikan të Krediteve, për të krijuar lehtësi lexueshmërie, transferimi dhe vazhdimi të studimeve universitare në universitetet e tjera brenda dhe jashtë vendit.

Në funksion të përmbushjes së objektivave të mësipërm Sektori i Auditimit të Brendshëm në UD, ka përcaktuar objektivat e tij për të realizuar misionin dhe rolin e auditimit të brendshëm, dhënien e sigurisë të arsyeshme për titullarin e Universitetit, në mënyrë të pavarur dhe objektive, këshilla për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm, nëpërmjet të cilave synon:

- Programimin dhe kryerjen e auditimeve në bazë të planit të miratuar, duke ruajtur frekuencën e auditimit, vlerësimin e riskut dhe nivelin e materialitetit;
- Vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe dhënien e rekomandimeve për vlerësimin e tij;
- Ndjekjen në vazhdim të rekomandimeve të dhëna nga auditimet, në bazë të planit të miratuar për ndjekjen e tyre;
- Minimizimin e kostove të auditimit duke u përqëndruar në sistemet apo fushat me risk të lartë;
- Ndikimin dhe impaktin e shkaktuar nga Covid 19 për ekspozimin e ri të riskut, rivlerësim të nivelit të riskut pasi vlerësimi aktual është bazuar në disa fusha, që tashmë janë të ndryshuar.

Objektivat e përcaktuara kanë shërbyer si bazë për hartimin dhe zbatimin e planeve strategjike dhe vjetore të veprimtarisë së kësaj njësie auditimi, si dhe për monitorimin e vazhdueshëm të progresit të rekomandimeve të adresuara.

Objektivat e vendosura nga grupi i vlerësimit lidhen me:

- Monitorimin dhe vlerësimin e realizimit të misionit të veprimtarisë së këtij Sektori në përputhje me standardet ndërkombëtare të pranuar;
- Vlerësimin e efektivitetit dhe efikasitetit të këshillave dhe rekomandimeve të adresuara për subjektet e audituara, dhe;
- Përcaktimin e fushave që kërkojnë vëmendje më të madhe dhe ndërhyrje për përmirësim.

Drejtimet e përcaktuara në programin e vlerësimit dhe të shqyrtuara nga grupi i vlerësimit janë:

1. Vlerësimi i veprimtarisë sipas kritereve të përcaktuara në Metodologjinë e Vlerësimit të Jashtëm të Cilësisë.
2. Monitorimi i zbatimit të rekomandimeve nga vlerësimi i kryer nga vlerësues të tjerë të jashtëm.

Dosjet e rishikuara për vlerësim nga grupi janë të gjitha të hartuara për angazhim auditimet e kryera në zbatim të Planit vjetor për vitin 2020 dhe vitin 2021. Ato përfaqësojnë gjashtë angazhim auditime të kryera në:

Viti 2020:

- Drejtoria e Investimeve dhe Prokurimeve Publike

Viti 2021:

- Drejtoria e Menaxhimit Financiar (paga, shpenzime, vendimet gjygjësore);
- Drejtoria e Menaxhimit Financiar (menaxhimi i aktiveve);
- Drejtoria e Investimeve Publike (pronat dhe kontratat e qerasë);
- Auditim mbi procedurat e dhënies së bursave 2019-2020;
- Auditim mbi zbatimin e vendimeve, urdhërave dhe shkresave të Bordit të Administrimit.

Grupi i vlerësimit e realizoi këtë angazhim nëpërmjet - *Metodës së përdorimit të pyetësorëve dhe konfirmimit*, të përcaktuar në Kapitullin V të Manualit të Auditimit të Brendshëm, të ndryshuar. Kjo metodë u vlerësua nga grupi si e përshtatshme dhe efektive për këtë vlerësim sepse informacioni i siguruar është i drejtpërdrejtë dhe i jep mundësi grupit të krijojë siguri në një nivel të pranueshëm për funksionimin në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm të pranuar, të kësaj njësie auditimi.

Grupi i vlerësimit i përbërë nga Zj.Albana Gjinopulli, përgjegjëse grupi, Zj.Nevila Piciri dhe Z.Sokol Bundo, anëtarë grupi, realizuan këtë vlerësim nga data 12 – 29 Korrik 2022.

Mbështetur në Programin “Për vlerësimin e jashtëm të cilësisë së njësive të auditimit të brendshëm në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës”, nr.12875/1, datë 01.07.2022, grupi i vlerësimit përgatiti pyetësorët për zhvillimin e intervistave me: Rektorin e Universitetit, Kryetaren e Bordit të Administrimit dhe stafin e audituesve të brendshëm.

III. GJETJET DHE KONKLUZIONET

Grupi i vlerësimit në respektim të drejtimeve të përcaktuara në Programin për vlerësimin e jashtëm të cilësisë nr.12875/1, datë 01.07.2022, vlerësoi veprimtarinë e Sektorit të Auditimit të Brendshëm në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës, nëpërmjet verifikimit të plotësimit të kriterëve të përcaktuara për çdo standard në Metodologjinë e Vlerësimit të Jashtëm të Cilësisë, si dhe adresimit të rekomandimeve të përshtatshme për gjetjet dhe konstatimet e evidentuara.

Vlerësimi i veprimtarisë së kësaj njësie auditimi të brendshëm është mbështetur në kuadrin rregullator në fuqi për auditimin e brendshëm në sektorin publik, i cili bazohet në standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm, duke u fokusuar në identifikimin e fushave që paraqesin mangësi për të rekomanduar përmirësimin në të ardhmen.

• **STANDARD ISSPA 1000 - QËLLIMI, AUTORITETI DHE PËRGJEGJËSIA**

Zbatimi i këtij standardi ka si qëllim që autoriteti dhe përgjegjësia e veprimtarisë së auditimit të brendshëm duhet të përkufizohet formalisht në Kartën e Auditimit të Brendshëm, të miratuar nga menaxhimi.

Karta e Auditimit të Brendshëm është dokumenti bazë që rregullon veprimtarinë audituese në Sektorin e Auditimit të Brendshëm. Karta Njësive të Auditimit të Brendshëm në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës është hartuar nga Sektori i Auditimit të Brendshëm dhe është miratuar nga Bordi i Administrimit në Universitetin e Durrësit me Vendim nr.14, datë 12.03.2018, si dhe është dërguar për informacion në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në MFE.

Grupi i vlerësimit nga shqyrtimi i këtij dokumenti evidenton se Karta e Auditimit të Brendshëm i përmbahet strukturës së përcaktuar në kuadrin rregullator në fuqi (ligjit nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe Manualit të Auditimit të Brendshëm miratuar me urdhër të Ministrit të Financave nr.100/2016, por në përmbajtje ka nevojë për përmirësim.

- **Në nenin 3, pika 2 - Misioni**, ndër të tjera përmendet – Ministri i Financave, në një kohë që aktualisht është Ministri i Financave dhe Ekonomisë. Në lidhje me këtë emërtim sugjerohet me qëllim që ky dokument dokument të mos ndryshohet shpesh, të përcaktohet si - ministri përgjegjës për financat;
- **Në nenin 3, pika 11 – Sigurimi i cilësisë dhe programi i përmirësimit**, përcaktohet ndër të tjera se: “..... Drejtuesi i NJAB do të komunikojë me komitetin e auditimit, “. Në një kohë që në Universitetin e Durrësit nuk është krijuar dhe nuk funksionon Komiteti i Auditimit të Brendshëm. Nga grupi sugjerohet se ky përcaktim duhet të hiqet;
- **Në germen b) të nenit 3 pika 6 – Organizimi**, përcaktohet se: “.... Bordi i Administrimit do të miratojë: Programet e angazhimit”. Bazuar në Standardin 2060 – Raportimi në Menaxhimin e Lartë dhe në Bord – Bordi nuk miraton programet çdo angazhimi. **Mbas miratimit të planit vjetor nga Bordi, miratimi i programeve të çdo angazhimi bëhet nga Drejtuesi i NJAB;**
- Në këtë dokument nuk evidentohet i përcaktuar komunikimi dhe raportimi në strukturën përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm;

- Ky dokument nuk ka përfshirë ndryshimet e Manualit me Urdhërin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.4, datë 10.01.2020 “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Manualin e Auditimit të Brendshëm miratuar me urdhërin nr.100, datë 25.10.2016”.

Në këto kushte, grupi i auditimit, vlerëson se Karta e Auditimit të Brendshëm duhet të përmirësohet në lidhje me specifikimet e mësipërme.

Veprimtaria e Universitetit të Durrësit bazohet në **ligjin nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”**. Në nenin 116 “Kontrolli dhe Auditimi”, të këtij ligji, ndër të tjera përcaktohet se: *“Krijimi dhe funksionimi i njësive të auditimit të brendshëm bëhen në përputhje me aktet e brendshme të institucionit”*.

Ky përcaktim bie në kundërshtim me nenin 1 dhe pikën 3 të nenit 10 të ligjit nr.114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji. Sipas të cilave nuk janë aktet e brendshme të Universitetit të Durrësit që rregullojnë krijimin dhe funksionimin e njësive të auditimit të brendshëm.

Në pikën 4 të **Udhëzimit të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr.27, datë 29.12.2017** “Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të arsimit të lartë” përcaktohet se: “Struktura administrative në nivel institucioni konsiderohen:

1. Bordi i Administrimit;
2. Administratori i institucionit;
3. Strukturat e auditimit të brendshëm, etj.

Por në pikën 17 të udhëzimit të sipërcituar theksohet se strukturat e auditimit të brendshëm janë në varësi të Bordit të administrimit të institucionit publik të arsimit të lartë.

Në të njëjtin akt hasim me dy noncione të ndryshme

- **në pikën 4** përcaktohet varësia e NJAB nga “Administratori”, i cili duke qenë menaxhues kryesor i fondeve publike është subjekt i auditimit të brendshëm.
- **në pikën 17** përcaktohet varësia e NJAB tek Bordi i Administrimit.

Në këndvështrimin tonë si grup auditimi, ky akt nënligjor ka sjellë një perceptim jo të saktë të varësisë së kësaj njësie të rëndësishme për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësi publike.

Universiteti i Durrësit në funksion të zhvillimit të veprimtarisë së tij dhe përmbushjes së objektivave të vendosura ka përcaktuar strukturën dhe ka miratuar Statusin e UD miratuar me urdhër të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr.385, datë 09.07.2018 “Për miratimin e Statutit të Universitetit “Aleksandër Mosiu” Durrës”, i ndryshuar.

- **Në nenin 24 të këtij Statuti** “Njësi ndihmëse qendrore” janë përcaktuar strukturat administrative të UD, si më poshtë:
 - Bordi i Administrimit
 - Administratori i Institucionit
 - Strukturat e Auditimit të Brendshëm, etj
- **Në nenin 102 të këtij Statuti** “Kontrolli dhe auditimi” përcaktohet se *“Kontrolli dhe auditimi i brendshëm në UD dhe në njësitë e tij përbërëse realizohen nga njësia e auditimit të brendshëm. Krijimi dhe funksionimi i njësive të auditimit të brendshëm bëhet me vendim të Bordit të Administrimit dhe funksionimi i tyre bazohet në rregulloren e hartuar prej tij”*.

Bazuar në kuadrin rregullator në fuqi për auditimin e brendshëm, *kontrolli i brendshëm në njësi publike* nuk realizohet nga NJAB, por kjo NJAB vlerëson efektivitetin e sistemeve të kontrollit të brendshëm që funksionojnë në njësinë publike.

“..... funksionimi i tyre bazohet në rregulloren e hartuar prej tij”. Ky përcaktim bie në kundërshtim me nenin 1 dhe pikën 3 të nenit 10 të ligjit nr.114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Përveç paqartësisë në aktet e sipërcituarar, aktualisht Sektori i Auditimit të Brendshëm, në aspektin e planifikimit, kryerjes dhe raportimit të veprimtarisë audituese:

- ka krijuar *pavarësi funksionale*, pra zhvillon veprimtarinë e tij në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor në fuqi. Bordi i Administrimit miraton dokumentat kryesore si: Karta e Auditimit të Brendshëm, Plani Strategjik dhe Vjetor dhe Raporti vjetor i veprimtarisë, si dhe merr informacion të përmbledhur në përfundim të angazhimeve të auditimit.
- ka siguruar *pavarësi organizative*, pra sipas përcaktimeve të mësipërme Sektori i Auditimit të Brendshëm në strukturën organizative ka varësi dhe raporton tek Bordi i Administrimit të UD, si dhe komunikon në mënyrë të vazhdueshme me Rektoren dhe Kryetaren e Bordit të Administrimit, si titullarë të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës.

Nga ana e strukturave të Universitetit të Durrësit na u paraqit një dokument me emërtimin **Rregullore Financiare**. Rregullorja Financiare e UD është miratuar me Vendim të Bordit të Administrimit nr.53, datë 19.08.2021 “Për miratimin e Rregullores Financiare të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës”.

Në nenin 26 të Kreun II “Njësia e Auditimit të Brendshëm” të kësaj rregulloreje janë përcaktuar niveli i strukturës, mënyra e funksionimit të NJAB, qëllimi i shërbimit të auditimit të brendshëm, si dhe detyrat dhe përgjegjësitë e kësaj njësie të auditimit të brendshëm. Në lidhje me këto përcaktime grupi i auditimit ka disa sugjerime si më poshtë:

- Në pikën 2 përcaktohet se: “Procesi i AB duhet të përcaktojë një mekanizëm të përshtatshëm për tërheqjen e vërejtjeve lidhur me gjetjet e auditimit dhe rekomandimet e tij, në aktet ligjore dhe nënligjore financiare”.

Në lidhje me këtë përcaktim theksojmë se AB nuk është proces por është një shërbim që kalon nëpër disa faza të përcaktuara dhe përmban në vetvete shumë procese. Ky shërbim nuk tërheq vërejtje por jep këshilla dhe rekomandime për menaxhimin e njësive publike.

- Në germën a të pikës 5 përcaktohet se: “NJAB ka për detyrë – të sigurojë përgjegjësinë institucionale të Universitetit”.

Në lidhje me këtë përcaktim theksojmë se NJAB nuk siguron përgjegjësinë por vlerëson efektivitetin e sistemeve të kësaj njësie publike. Përgjegjësia e kësaj njësie publike (UD) është e përcaktuar me akte të veçanta ligjore dhe nënligjore.

- Në germën b) të pikës 5 përcaktohet se: “NJAB ka për detyrë – të ofrojë garanci objektive për organizmat mbikqyrës”.

Në lidhje me këtë përcaktim theksojmë se NJAB nuk ofron garanci objektive por jep siguri objektive dhe ofron këshilla për menaxhimin.

- Në germën f) të pikës 5 përcaktohet se: “NJAB ka për detyrë – vlerësimin dhe theksimin e proceseve”.

Në lidhje me këtë përcaktim theksojmë se NJAB nuk ka për detyrë të theksojë proceset por të vlerësojë sistemet

- Në germën i) të pikës 6 përcaktohet se: NJAB brenda muajit Mars paraqet pranë Bordit të Administrimit raportin vjetor të veprimtarisë të tij dhe realizimin e detyrave të lëna nga ky organ.

Ky përcaktim është në kundërshtim me pikën 4.3 të kapitullit IV të MAB, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Mbas miratimit nga titullari i njësive publike NJAB dërgon raportin vjetor të

veprimtarisë më datë 15 shkurt të vitit pas ardhës në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

- Në këtë nen të RRegullores nuk trajtohet bashkëpunimi dhe raportimi zyrtar në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në MFE.
- Në këtë Rregullore nuk janë trajtuar të ndara detyrat dhe përgjegjësitë e drejtuesit të NJAB dhe audituesve të brendshëm të njësisë së auditimit të brendshëm në UD.

Në këto kushte, grupi i vlerësimit evidentohet se kjo rregullore duhet të përditësohet duke marrë parasysh ndryshimet dhe përmirësimet e duhura.

Në lidhje me përfshirjen e audituesve të brendshëm në veprimtari operationale evidentohet nëpërmjet komunikimit me audituesit e brendshëm se në këtë njësi publike audituesit e brendshëm nuk përfshihen në veprimtari operationale, përveç veprimtarisë së auditimit të brendshëm.

Nga grupi vlerësohet se kjo praktikë është bazuar në germën a të nenit 17 të ligjit nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” ku shprehet se “Audituesve të brendshëm u ndalohet: a) të përfshihen në kryerjen e funksioneve dhe veprimtarive të tjera të njësisë publike, përveç veprimtarisë audituese.

Drejtuesi i SAB dhe stafi i audituesve të brendshëm pohojnë gjatë bashkëbisedimit se kanë akses të pakufizuar në informacion, dokumentacion, mjete dhe punonjës në çdo njësi subjekt auditimi. Po kështu edhe në dokumentacionin e shqyrtuar nga grupi i vlerësimit, Raporti mbi veprimtarinë e AB në Universitetin e Durrësit për vitin 2020, dërguar në DH/AB në mënyrë elektronike dhe Raporti mbi veprimtarinë e AB në Universitetin e Durrësit për vitin 2021, miratuar nga Bordi me Vendim nr.17/1, datë 24.03.2022 dhe dërguar zyrtarisht në DH/AB në MFE nr.275/1, datë 24.03.2022 “Raporti Vjetor i auditimit të brendshëm për vitin 2021” nuk evidentohen problematika ose kufizime në lidhje me veprimtarinë e auditimit të brendshëm.

Grupi i auditimit evidenton se gjatë punës së tyre audituesit nuk kanë konstatuar shqetësime, gjë që ka krijuar kushtet që konkluzionet e audituesve të mbështeten në dokumentacion të besueshëm.

Linjat e raportimit nuk ishin të përcaktuara qartë por praktikisht funksiononin. Aktualisht SAB raporton tek niveli më i lartë i menaxhimit (Bordi i Administrimit), si dhe në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm (DH/AB), sipas përcaktimeve të ligjit nr.114/2015.

Gjatë periudhës së vlerësuar është paraqitur në mënyrë elektronike Plani Strategjik dhe Vjetor 2020-2022 dhe Raporti Vjetor 2020, si dhe është dërguar në mënyrë zyrtare Plani Strategjik dhe Vjetor 2021-2023 dhe Raporti 2021.

SAB ka hartuar raporte vjetore të veprimtarisë audituese ku ka analizuar rezultatet e angazhimeve të auditimit të kryera lidhur me vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, por evidentohet se Raporti i vitit 2020 është dërguar në mënyrë elektronike ndërsa Raporti i vitit 2021 është dërguar në mënyrë zyrtare dhe është miratuar nga Bordi i Administrimit të UD ;

Në Raportin mbi veprimtarinë e AB në Universitetin e Durrësit për vitin 2021, miratuar nga Bordi me Vendim nr.17/1, datë 24.03.2022 dhe dërguar zyrtarisht në DH/AB në MFE nr.275/1, datë 24.03.2022 “Raporti Vjetor i auditimit të brendshëm për vitin 2021” nuk evidentohen problematika lidhur me burimet njerëzore, “.... Për periudhën raportuese struktura e AB është e plotësuar“.

Drejtuesi i NJAB dhe audituesi i brendshëm zotërojnë njohuri mbi rolin dhe përgjegjësitë e tyre, të parashikuara në kuadrin ligjor rregullator si: ligji 114/2015, Manuali i Auditimit të Brendshëm, të ndryshuar, Karta e Auditimit të Brendshëm dhe Kodi i Etikës, kjo falë certifikimit si “Auditues i brendshëm në sektorin publik”. Punonjësi i ri është në proces certifikimi.

Nga intervistimi i stafit auditues, si dhe duke konsideruar përvojën e gjatë në profesion të tyre, vlerësojmë se audituesit kanë të qartë dallimin ndërmjet shërbimeve të sigurisë dhe këshillimit, si dhe njohin rolin e menaxhimit të lartë për zbatimin e rekomandimeve të adresuara në raportet e hartuara.

Referimi në standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm është evident në të gjitha dokumentet bazë për funksionimin e kësaj Njësie Auditimi të Brendshëm.

Kodi Etik për audituesit e brendshëm është një tjetër referencë e rëndësishme e përdorur në të gjithë dokumentat e hartuara për funksionimin e kësaj njësie auditimi.

Sa trajtuar më sipër grupi i vlerësimit rekomandon:

Rekomandim: Sektori i Auditimit të Brendshëm në Universitetin e Durrësit në bashkëpunim me Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, të propozojë ndryshime në aktet ligjore dhe nënligjore në fushën e arsimit të lartë, për respektimin e parimeve dhe standardeve ndërkombëtare të auditimit të brendshëm, të cilat duhet të zbatohen në të gjitha institucionet publike të arsimit të lartë.

Rekomandim: Sektori i Auditimit të Brendshëm të përditësojë Kartën e Auditimit të Brendshëm, plotësimin e këtij dokumenti sipas përcaktimeve në Manualin e Auditimit të Brendshëm, të ndryshuar, dërgimin për miratim në Bordin e Administrimit dhe përcjelljen zyrtare pranë DH/AB në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Rekomandim: Sektori i Auditimit të Brendshëm t'i propozojë menaxhimit të Universitetit të Durrësit përditësimin e "Rregullores Financiare të Universitetit të Durrësit" me përcaktimet e qarta mbi të drejtat dhe përgjegjësitë e audituesve të njësisë së auditimit të brendshëm, komunimin me menaxhimin, si dhe bashkëpunimin me të gjitha strukturat e kësaj njësie publike, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për auditimin e brendshëm

Opinion i grupit të vlerësimit për përputhshmërinë e veprimtarisë audituese me përcaktimet në Manualin e Auditimit të Brendshëm dhe plotësimin e kriterëve të Standardit 1000 thekson faktin se:

Sektori i Auditimit të Brendshëm në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës funksionon:

-  - Portokalli- në përputhje të pjesshme me standardin, por kërkohen përmirësime të domosdoshme në fushën ku janë adresuar rekomandime.

• STANDARD ISSPA 1100 – PAVARËSIA DHE OBJEKTIVITETI

Pavarësia dhe objektiviteti si parimet e rëndësishme të funksionimit të auditimit të brendshëm nënkuptojnë që në planifikimin, kryerjen e procedurave audituese, raportimin e rezultateve dhe rekomandimet audituesit të përdorin profesionalizmin e tyre dhe të jenë të pa ndikuar, në fakt dhe në dukje.

Në lidhje me organizimin dhe funksionimin e Njësisë së Auditimit të Brendshëm, konstatojmë së shërbimi i auditimit të brendshëm pranë Universitetit të Durrësit është ngritur dhe organizuar si Sektor, i përbërë nga tre punonjës.

Ngritja dhe organizimi i Sektorit të Auditimit të Brendshëm është bërë në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 10, të ligjit 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" dhe pikën 3 të VKM nr.83, datë 03.02.2016 "Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar.

Njësia e Auditimit të Brendshëm është e organizuar si **SEKTOR (1+2)**, por në strukturën organizative nuk paraqitet qartë varësia direkte tek Bordi i Administrimit të Universitetit të Durrësit megjithëse aktualisht NJAB raporton drejtpërdrejt tek ky Bord.

Pavarësia e audituesve të brendshëm është e përcaktuar në pikën 3 të nenit 26 të Rregullores Financiare të UD, tek Statuti i UD dhe në nenin 7 “Pavarësia dhe Objektiviteti” të Kartës së Auditimit të Brendshëm, të miratuar me Vendim të Bordit të Administrimit nr.14, datë 12.03.2018, por aktualisht ka paqartësi në funksionimin e kësaj njësie (të gjitha dokumentat e NJAB miratohen nga Administratori i UD ose i bëhen me dije Administratorit të UD, i cili në zbatim të legjislacionit të auditimit të brendshëm është subjekt auditimi).

UD aktualisht nuk ka të ngritur Komitet të Auditimit të Brendshëm, për të mbështetur funksionimin e SAB në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Nga ana e Drejtuesit të SAB dhe e audituesve të brendshëm bëhen përpjekje të vazhdueshme nëpërmjet komunikimit zyrtar me titullarin (Bordin e Administrimit) ku evidentohet që kjo NJAB, ka komunikim të drejtpërdrejtë me Bordin.

Bazuar në Standardin 1110 – “Pavarësia Organizative” dhe në **Standardin 2060** – Raportimi në Menaxhimin e Lartë (Bord). Pavarësia organizative arrihet në mënyrë efektive kur Drejtuesi i Auditimit të Brendshëm (DAB) dërgon për miratim në Bord:

- Kartën e auditimit të brendshëm;
- Planin strategjik dhe vjetor të auditimit të brendshëm;
- Raportin Vjetor të auditimit të brendshëm;
- Programin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.

Në Kartën e Auditimit, si dhe në procedurat e shqyrtuara evidentohet kujdesi për mbrojtjen e pavarësisë dhe objektivitetit të audituesve nga kërcënimet që i çenojnë. Aktualisht është e paqartë varësia direkte në strukturën organizative por kjo NJAB ka komunikim të drejtpërdrejtë me Bordin e Administrimit, si dhe pavarësia funksionale, për të cilën evidentohet se veprimtaria audituese kryhet sipas përcaktimeve në aktet ligjore e nënligjore, në fuqi, por ka vend për përmirësime.

Në strukturën organizative të miratuar me Vendim të Bordit të Administrimit nr.30, datë 31.05.2018 “Për miratimin e strukturës së përgjithshme të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës”, e ndryshuar me Vendim të Bordit të Administrimit nr.22, datë 31.05.2019, nuk është e përcaktuar qartë varësia organizative e NJAB tek Bordi i Administrimit.

Struktura është planifikuar me tre punonjës (1 P/Spektori dhe 2 auditues të brendshëm) dhe aktualisht funksionon me tre punonjës (1 P/Spektori dhe 2 auditues të brendshëm). Komunikimi ndërmjet menaxhimit të lartë (Bordit të Administrimit) dhe NJAB është prezent në të gjitha dosjet.

Bordi ka miratuar KAB, Planit Strategjik dhe Vjetor, Raportin vjetor dhe programet e angazhimit (programet e angazhimit duhet të hartohen nga grupi i auditimit), ndërsa projekt-raportet dhe raporte përfundimtare, hartohen nga NJAB dhe dërgohen nëpër subjekte duke bërë me dije Administratorin e UD, duke mos respektuar pavarësinë e AB, sepse administratori është subjekt auditimi.

Nga grupi i vlerësimit u evidentua se nuk ka patur raste të përfshirjes së audituesve në veprimtari operacionale.

Plani vjetor dhe strategjik i veprimtarisë së NJAB për vitin 2020-2022 është hartuar nga NJAB por për shkak të Pandemisë Globale dhe gjendjes shëndetësore të AB (referuar dok) është paraqitur në mënyrë elektronike në DH/AB pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Plani vjetor dhe strategjik i veprimtarisë së NJAB për vitin 2021-2023 është hartuar nga NJAB dhe është miratuar nga titullari (Bordi i Administrimit) me Vendim nr.73, datë 20.10.2020 sipas përcaktimeve ligjore, dhe është paraqitur zyrtarisht në DH/AB pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Drejtuesi i Auditimit të Brendshëm në Universitetin e Durrësit është emëruar me Urdhër të Rektorit nr.70/5, datë 11.10.11 “Për emërim punonjësish në kohë të plotë” ndryshuar me Urdhër të Administratorit nr.176, datë 03.06.2019 “Ndryshim në emërimin për shkak të ndryshimit të strukturës”. Ky emërim është në respektim të kriterëve ligjore neni 11 i ligjit 114/2015, pra është e certifikuar si AB dhe ka përvojë pune mbi 5 vjet në auditim të brendshëm.

Grupi i vlerësimit evidenton se Drejtuesi i Auditimit të Brendshëm në Universitetin e Durrësit është emëruar në respektim të kërkesave të nenit 11 të ligjit nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe në përputhje me kërkesat për aftësitë dhe kompetencat që drejtuesi duhet të zotërojë.

Nga grupi i vlerësimit dhe nga intervistat me stafin e Sektorit të Auditimit të Brendshëm nuk u evidentua të ketë procedurë të hapur ose kërkesë për shkarkimin e Drejtuesit të NJAB.

Përgatitja dhe nënshkrimi i Deklaratës së Konfliktit të Interesit për çdo angazhim auditimi është një ndër masat parandaluese për shmangien e kërcëimit të pavarësisë apo konfliktit të interesit. Në rastet e shqyrtuara nuk u evidentua ndonjë situatë e tillë

Karta e Auditimit të Brendshëm është dokumenti bazë që rregullon veprimtarinë audituese në Sektorin e Auditimit të Brendshëm. Karta Njesisë së Auditimit të Brendshëm në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës është hartuar nga SAB, është miratuar nga Bordi i Administrimit në UD, me Vendim nr.14, datë 12.03.2018 dhe është dërguar për informacion në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në MFE.

Grupi i vlerësimit nga shqyrtimi i këtij dokumenti evidenton se Karta e Auditimit të Brendshëm i përmbahet strukturës së përcaktuar në kuadrit rregullator në fuqi (ligjit nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe Manualit të Auditimit të Brendshëm miratuar me urdhër të Ministrit të Financave nr.100/2016, i ndryshuar dhe ka nevojë për përmirësime. *Trajtuar më gjerësisht në Standardin 1000*

Nga komunikimi me audituesit e brendshëm u evidentua se UD nuk ka të miratuar “Grupin për menaxhimin strategjik”. Në pikën 2 të nenit 41 të Rregullores Financiare të UD, miratuar me Vendim të Bordit të Administrimit nr.53, datë 19.08.2021 “Për miratimin e Rregullores Financiare të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës”, përcaktohet përbërja e GMS. Në këtë përcaktim evidentohet se Drejtuesi i NJAB nuk është anëtar pa të drejtë vote, sipas përcaktimeve në pikën 2 të nenit 27 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

Gjatë vlerësimit grupi nuk ka evidentuar raste të përfshirjes së audituesve të brendshëm në veprimtari të tjera operationale, të cilat nuk kanë të bëjnë me shërbimin e auditimit të brendshëm duke u respektuar germa a e nenit 17 “Kufizimet në veprimtarinë e audituesve të brendshëm”. të ligjit 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.

Gjatë periudhës së vlerësimit (viti 2020 dhe 2021) nuk u evidentua në asnjë rast përfshirja e audituesve në grupe për hartim procedurash, vendosje kontrollesh apo ngritje të sistemeve por është treguar kujdesi i duhur për dhënien e rekomandimeve sa më objektive për përmirësimin e procedurave, etj.

Drejtuesi i SAB dhe audituesi i brendshëm zotërojnë eksperiencë të gjatë në profesionin bazë dhe si auditues i brendshëm dhe duke patur komunikim të mirë me vartësit, bashkëpunimi për kuptimin dhe

qartësimin e procesit të identifikimit dhe raportimit të dëmtimeve të pavarësisë dhe objektivitetit ka qenë efektiv në kryerjen e veprimtarisë.

Stafi audituesve gjatë bashkëbisedimeve theksoi faktin se aksesin në informacionin që shqyrtonte në njësitë e audituara ka qenë i pakufizuar, pra nuk kanë hasur asnjëherë vështirësi të këtij lloji, por me eksperiencë në auditim ata e kanë të qartë si të veprojnë në rastet kur nuk i jepet informacioni i nevojshëm.

Po kështu në Raportin mbi veprimtarinë e AB në Universitetin e Durrësit për vitin 2020 dhe 2021 nuk përmenden problematika të hasura në këtë drejtim.

Nga intervistimi u evidentuan njohuri të mjaftueshme të stafit për legjislacionin lidhur me etikën profesionale dhe trajtimin, reagimin ndaj dhuratave të ofruara nga subjekti i audituar

Stafi auditues në këtë njësi është i konsoliduar (punësuar si auditues të brendshëm në Universitetin e Durrësit, për rrjedhojë ata nuk kanë pasur kufizime në kryerjen e angazhimeve, megjithatë e gjithë NJAB ka të qartë kufizimet e përcaktuara në ligjin 114/2015, për mos angazhimin në auditime pranë drejtorisë ku më parë kanë qenë punësuar (për 3 vite). Ky kujdes ka qenë më i shtuar për një nga punonjëset e NJAB të transferuar nga sektor tjetër i Universitetit të Durrësit.

Stafi i auditimit në këtë njësi ka pësuar ndryshime të përbërjes për periudhën objekt vlerësimi, (2020-2021), por në bashkëbisedimin me audituesit e brendshëm u konfirmua njohja dhe respektimi i detyrimit të përcaktuar në ligjin 114/2015, për ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave dhe informacioneve që ata disponojnë për shkak të funksionit që kryejnë.

Monitorimi i progresit të rekomandimeve të vlerësimit të kryer nga Kontrolli i Lartë i Shtetit.

Veprimtaria e kësaj njësie auditimi është subjekt monitorimi nga Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH).

Programit të Auditimit të KLSH me nr.807/1, datë 01.09.2020, “Për auditimin financiar në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës”, i ndryshuar. Ky auditim i përket periudhës 1 Janar 2013 – 20 Shtator 2020.

Gjatë auditimit, nga ana e grupit të KLSH nuk është vlerësuar funksionimi i strukturës së auditimit të brendshëm. Dhe në këto kushte nuk janë dhënë rekomandime për Sektorin e Auditimit të Brendshëm. Në këtë program auditimi, grupi ka trajtuar këto drejtime:

- Drejtimi 1: “Vlerësimi i zbatimit të kontratave për ndërtimin e kampusit universitar”;
- Drejtimi 2: “Mbi planifikimin dhe zbatimin e buxhetit të Institucionit”;
- Drejtimi 3: “Mbi krijimin dhe shlyerjen e detyrimeve”.

Grupi i vlerësimit evidenton se për periudhën objekt vlerësimi nuk është audituar nga KLSH veprimtaria audituese e NJAB në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës”.

Sa trajtuar më sipër grupi i vlerësimit rekomandon:

Rekomandim: Menaxhimi i Universitetit të Durrësit të përshijë në Grupin e Menaxhimit Strategjik, Drejtuesin e Sektorit të Auditimit të Brendshëm, si anëtar pa të drejtë vendimmarrje, për të siguruar një rol dhe funksion sa më efektiv, në kuadër të diskutimit të çështjeve që lidhen me sistemin e kontrollit të brendshëm, menaxhimin efektiv të risqeve dhe adresimin e mangësive të konstatuara nga auditimi i brendshëm.

Opinion i grupit të vlerësimit për përputhshmërinë e veprimtarisë audituese me përcaktimet në Manualin e Auditimit të Brendshëm dhe plotësimin e kriterëve të Standardit 1100 thekson faktin se:

Sektori i Auditimit të Brendshëm në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës funksionon

- - E gjelbër- në përputhje të plotë me standardin.

• **STANDARD ISSPA 1200 - AFTËSITË DHE KUJDESI I DUHUR PROFESIONAL**

Kuadri i Praktikave Profesionale të auditimit të brendshëm, kërkon që angazhimet e auditimit duhet të kryhen me aftësitë dhe kujdesin e duhur profesional. Në interpretimin e këtij standardi, audituesit e brendshëm duhet të zotërojnë njohuritë, aftësitë dhe kompetenca të tjera që nevojiten për të kryer përgjegjësitë e tyre individuale.

Stafi auditues aktual duke patur eksperiencë në këtë fushë zotëron njohuri të qarta lidhur me përcaktimet ligjore, mbi aftësitë dhe kompetencat që duhet të shfaqin gjatë kryerjes së angazhimeve, si dhe për mbështetjen e kolegëve në zgjidhjen e çështjeve të hasura gjatë kryerjes së proceseve audituese.

Audituesit e punësuar në SAB plotësojnë kërkesat e punësimit të përcaktuar në pikën 2/gërma “a”, “b” dhe “c” të nenit 11 të ligjit nr.114/2015, pasi plotësojnë kriterin e vjetërsisë, mbi 5 vjet si auditues i brendshëm për drejtuesin, mbi 5 vite pune në profesion për audituesin e brendshëm dhe të certifikuar si “Auditues i brendshëm të brendshëm në sektorin publik” ndërsa punonjësi i ri të NJAB ka mbi 3 vite në profesion dhe duhet të certifikohen brenda dy viteve të para të punësimit (aktualisht është në process certifikimi).

Audituesit kanë një eksperiencë pune në fushën e auditimit që varion nga 6 deri 8 vite dhe vjetërsi pune në profesion nga 22 deri në 30 vite. Ata zotërojnë aftësitë e nevojshme, përvojën dhe kompetencën e duhur për kryerjen e angazhimit të auditimit, si dhe përditësojnë rregullisht njohuritë e tyre. Drejtuesi i NJAB dhe audituesi i brendshëm janë të certifikuar si “Auditues i brendshëm në sektorin publik”.

Audituesi më me eksperiencë ka mbështetur dhe mbikqyrur audituesen e pa certifikuar, si në qartësimin e rolit dhe përgjegjësi të audituesit, por edhe në zgjidhjen e çështjeve të hasura gjatë kryerjes së angazhimeve të auditimit.

Grupi i vlerësimit e mbështet këtë konkluzion në analizimin e të dhënave të raportit vjetor mbi veprimtarinë e auditimit të brendshëm për vitin 2021.

TË DHËNA PËR AUDITUESIT E BRENDSHËM								
NR	Pozicioni	Arsimi Bazë	Niveli i Diplomës	Eksperiencia e Punës		Zhvillimi Profesional		
				Vitet e Punës Gjithsej	Vitet e Punës në AB	Çertifikimi	Trajnime në fushën e AB	
						Certifikuar	Viti 2020-2021	
1	Përgj. Sek	M Shkencor	MSC	15	5	2011	-	40
2	Specialist	M Shkencor	MSC	9	3.5	2015	22	40
3	Specialist	M Shkencor	MSC	3	0	-	-	-

Tabela 1. Të dhëna për audituesit e brendshëm

Nga shqyrtimi i dokumentacionit në gjashtë dosjet e hartuara për çdo angazhim, si më poshtë:

Viti 2020:

- Drejtoria e Investimeve dhe Prokurimeve Publike.

Viti 2021:

- Drejtoria e Menaxhimit Financiar (paga, shpenzime, vendimet gjyqësore);
- Drejtoria e Menaxhimit Financiar (menaxhimi i aktiveve);
- Drejtoria e Investimeve Publike (pronat dhe kontratat e qerasë);
- Auditim mbi procedurat e dhënies së bursave 2019-2020;
- Auditim mbi zbatimin e vendimeve, urdhërave dhe shkresave të Bordit të Administrimit.

NJAB në përgjithësi ka planifikuar dhe kryer veprimtarinë bazuar në kërkesat e Manualit të Auditimit, të ndryshuar pra ka vend për përmirësime të vazhdueshme në të ardhmen. Në veprimtarinë e auditimit grupi i punës konstatoi se:

- Në angazhimet e auditimit janë respektuar afatet e përcaktuara në MAB, të ndryshuar;
- Programi i Auditimit nuk i përmbahej strukturës së miratuar në MAB, të ndryshuar, Formatit Standard, Kap.IV.
- Mungojnë drejtimit e auditimit, të cilat duhet të trajtoheshin në projekt-raporte dhe raporte përfundimtare.
- NJAB nuk ka dërguar në formë shkresore pranë strukturës së audituar planin e sugjeruar të veprimit dhe në asnjë rast ky plan nuk është plotësuar nga subjekti i audituar dhe kthyer zyrtarisht.

Përfundimisht sa sipër, audituesit e brendshëm njohin procedurat e përcaktuara në Manualin e AB dhe metodologjinë për auditimin e fushave dhe sistemeve të veçanta, pasi janë trajnuar për të aplikuar këtë metodologji, por ka vend për përmirësime të domosdoshme. Trajtuar më gjerësisht në Standardet 2100, 2200.

Nga intervistimi i kryer me stafin konstatohet se eksperiencat e tyre në profesion iu kanë mundësuar njohuri të mjaftueshme për identifikimin e rasteve të mashtrimit dhe mënyrat si duhet të reagojnë në rastet kur gjykojnë se parregullsitë e evidentuara çojnë në dyshime për ndjekje penale, kjo falë dhe temave e rasteve studimore të prezantuara në trajnimet e vijueshme profesionale të organizuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë apo ofruesve të tjerë të trajnimeve.

SAB nuk ka në përbërjen e tij auditues IT dhe në periudhën objekt vlerësimi nuk është kryer asnjë angazhim auditimi në këtë fushë, por stafi bën përpjekje për afësimin lidhur me identifikimin e riskut në proceset IT duke përditësuar rregullisht njohuritë në këto fusha

Në angazhimet e auditimit të kryera për periudhën objekt vlerësimi nuk ishte planifikuar dhe as nuk ishte kryer ndonjë angazhim auditimi IT, por stafi i intervistuar pohon se teorikisht zotërojnë njohuri për atë sa parashikon Manuali i Auditimit të Brendshëm dhe rastet praktike të prezantuara në trajnime për teknikat që përdoren në këtë lloj auditimi

Nga grupi i vlerësimit u konstatua se stafi i SAB me përvojën profesionale dhe etikën e përdorur, zotëron njohuri të mjaftueshme për menaxhimin e zgjidhjen e konflikteve, megjithëse nuk u evidentuan raste të konflikteve ndërmjet audituesve dhe subjekteve të audituara për periudhën objekt vlerësimi.

Nga dokumentacioni në dosjet e shqyrtuara u konstatua se audituesit, në raportet e hartuara nuk jepnin një panoramë të situatës, me rrjedhë logjike që ndërlidh gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet për parregullsitë e vërejtura, si dhe nuk jepej vlerësim ose opinion i përgjithshëm për çdo sistem të vlerësuar.

Gjykuar nga niveli i pranimit të rekomandimeve të adresuara në secilin subjekt grupi i vlerësimit e konsideron këtë si tregues që rekomandime janë vlerësuar të dobishme dhe praktike për t'u zbatuar nga njësitë e audituara pra mesazhi i audituesve në rekomandimet e adresuara ka qenë i qartë.

Në SAB në Universitetin e Durrësit, drejtuesi dhe audituesit janë të certifikuar dhe janë trajnuar për periudhën 2020-2021 sipas Programeve të TVP të miratuara nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë.

Për periudhën objekt vlerësimi nuk evidentua në asnjë rast përfshirja në grupet e auditimit të ekspertëve jo auditues me njohuri në fusha specifike. *Trajtuar në gjerësisht në Standardin 2200.*

Gjatë vitit 2020-2021, stafi auditues i SAB ka respektuar metodologjinë e përcaktuar për vlerësimin e menaxhimit të risqeve dhe plotëson për çdo angazhim auditimi Formatin Standard "Vlerësimi i risqeve për sisteme/fusha të veçanta", i cili është përditësuar sipas fushave të përgjegjësisë së njësisë publike.

Nga grupi i vlerësimit u evidentua se audituesit e brendshëm janë të pavaruar në vlerësimet e tyre dhe për çdo angazhim auditimi ishin përcaktuar objektivat, të cilët në shumë raste nuk ishin specifike sipas fushës së përgjegjësisë së kësaj njësie publike,

- Është e dokumentuar që audituesit kanë kryer fazën e vlerësimit paraprak të risqeve që i përkasin veprimtarisë e cila është në shqyrtim, përpara hartimit të Program Angazhim Auditimit.
- Janë hartuar formatet standard të vlerësimit të riskut:
 - Vlerësimi i Riskut të mjedisit të përgjithshëm të kontrollit (Formati Standard 4) dhe Vlerësimi i Riskut për sisteme/fusha që po auditohen (Formati Standard 5), ku dokumentohet që këto formate janë hartuar në përputhje me specifikat dhe objektin e veprimtarisë së njësisë së audituar, por në këto formate mungojnë komentet për mënyrën e vlerësimit.
 - "Formulari i plotësuar të vlerësimit të përgjithshëm të riskut" (Formati Standard 8), por në disa formate mungojnë komentet për mënyrën e vlerësimit.

Këto formate ishin prezent në të gjitha dosjet e vlerësuar

Opinion i grupit të vlerësimit për përputhshmërinë e veprimtarisë audituese me përcaktimet në Manualin e Auditimit të Brendshëm dhe plotësimin e kriterëve të Standardit 1200 thekson faktin se:

Spektori i Auditimit të Brendshëm në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës funksionon:

-  -E gjelbër në përputhje të plotë me standardin.

• STANDARD ISSPA 1300 SIGURIMI I CILËSISË DHE PROGRAMI I PËRMIRËSIMIT

Sipas këtij standardi, drejtuesi i njësisë së auditimit duhet të hartojë dhe të përditësojë programin për vlerësimin e brendshëm të cilësisë. Ky program bën të mundur vlerësimin e pajtueshmërisë së veprimtarisë audituese me kuadrin rregullator në fuqi, i cili ka pranuar standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm, nëpërmjet vlerësimit të efikasitetit e efektivitetit të kësaj veprimtarie duke identifikuar mangësitë e adresuar përmirësime.

Sigurimi i brendshëm i cilësisë së veprimtarisë audituese për periudhën objekt vlerësimi nuk dokumentuar në asnjë nga dosjet objekt shqyrtimi me asnjë formë të përcaktuar në MAB, të ndryshuar.

Spektori i Auditimit të Brendshëm në Universitetin “Aleksandër Mosiu” Durrës nuk ka miratuar “Programin për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë të Njësisë së Auditimit të Brendshëm” dhe nuk kryen rregullisht vlerësimet e brendshme të cilësisë (referuar dosjeve të shqyrtuara).

Procedura e vlerësimit të brendshëm për çdo Program angazhimi nuk kryhej me asnjë nga format e përcaktuara (as me monitorim të vazhdueshëm dhe as me vetëvlerësimet periodike), ndërsa vlerësimet e jashtme kryeheshin nga KLSH dhe DH/AB.

Grupi i auditimit vlerëson se audituesit e brendshëm në këtë NJAB nuk kryejnë vlerësimet e brendshme. Kjo për faktin se në pjesën më të mirë të angazhimeve i gjithë stafi i NJAB është pjesë e grupit të auditimit.

Sigurimi i brendshëm i cilësisë së veprimtarisë audituese për periudhën objekt vlerësimi nuk është dokumentuar në asnjë nga dosjet objekt shqyrtimi. Një Program i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë duhet të përmbajë komponentët sa më poshtë:

- Monitorimin e vazhdueshëm Aneksi 1 – plotësuar nga audituesi i brendshëm, Aneks 2 - i plotësuar nga Përgjegjësi i grupit dhe Aneks 3 – i plotësuar nga Drejtuesi i NJAB. Këto Aneksë duhet të përmbajnë standardet (2200, 2300, 2400, 2500 dhe zonat e përgjithshme) ku duhet të përshkruhen operacionet që rishikohen sipas standardeve, bazuar në pikën 7.1.1 të Kapitullin VII të MAB;
- Vetë-vlerësimin Periodik të NJAB – ku duhet të përmbajë pyetje për të vlerësuar cilësinë e kriterëve gjatë vetëvlerësimit periodik të cilësisë së brendshme të veprimtarisë së NJAB standardet (1000, 1100, 1200, 1300, 2000, 2100, 2200, 2300, 2400, 2500 dhe 2600).
- Sondazhi i subjektit të audituar - “Reagimet e subjektit të audituar”- shkresa e feedback që duhet të plotësohet nga subjekti i audituar për çdo dosje auditimi.

I gjithë ky proces duhet të realizohet sipas përcaktimeve në Kapitullin VII të Manualit të Auditimit të Brendshëm, të ndryshuar.

Duke qenë se procedura e vlerësimit të brendshëm për çdo Program angazhimi nuk kryhej me asnjë nga format e përcaktuara në Manualin e Auditimit të Brendshëm, edhe përcaktimi dhe miratimi i indikatorëve të vlerësimit të brendshëm të cilësisë nuk është realizuar nga NJAB.

Grupi i vlerësimit evidenton se Spektori i Auditimit të Brendshëm në Universitetin “Aleksandër Mosiu” Durrës nuk ka miratuar Programin për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë dhe nuk ka të përcaktuar Indikatorët e matjes së performancës, në funksion të synimit të vlerësimit të përputhshmërisë së saj me standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm dhe për t’i shërbyer raportimit të rezultateve të këtij vlerësimi.

Për arsyet e renditura në pyetjet më sipër është shpjeguar se mungesa e indikatorëve të matjes së performancës ka kushtëzuar hartimin e raporteve specifike të vlerësimit të performancës dhe si rrjedhim adresimin e rekomandimeve për përmirësim. Në këto kushte raportimi tek Titullari (Bordi i Administrimit) specifikisht për këtë procedurë nuk është kryer.

Pyetësi i reagimit ndaj angazhimit nuk i dërgohej zyrtarisht subjekteve të audituara me dërgimin e Raportit Përfundimtar, kështu që pyetësi nuk kthehej i plotësuar dhe nuk gjendej si pjesë e inventarit të çdo dosje

NJAB nuk ka dërguar në formë shkresore pranë subjektit të audituar formularin e marrjes së reagimeve (feedback-un) pas përfundimit të angazhimit auditimit.

Evidentohet se në raportet e angazhimeve të auditimit (në dosjet e vlerësuar) përdoret shpesh shprehja ky raport është “në përputhje me standardet ndërkombëtare” ose veprimtaria audituese është “në përputhje me standardet ndërkombëtare”.

Duke qenë se SAB nuk ka qenë subjekt i vlerësime të jashtme për më shumë se 5 vite, në këto kushte përdorimi i shprehjes “në përputhje me standardet ndërkombëtare”, nuk duhet të përdoret pasi ky pohim duhet të mbështetet nga rezultatet positive të këtyre vlerësimeve të jashtme.

Sa trajtuar më sipër grupi i vlerësimit rekomandon:

Rekomandim: Audituesit e Brendshëm, për çdo angazhim auditimi, të realizojnë monitorim të vazhdueshëm të veprimtarisë si në rolin e anëtarit dhe përgjegjës të grupit, ashtu dhe në rolin e drejtuesit të NJAB, për një monitorim sa më efikas të kësaj veprimtarie në përputhje me standardet ndërkombëtare, të pranuar.

Rekomandim: Sektori i Auditimit të Brendshëm të përgatisë dhe të dërgojë përmiratim Programin për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë së veprimtarisë audituese, ku të përcaktojnë mjetet që do përdoren për monitorim të vazhdueshëm dhe vetëvlerësim periodik, të cilat duhet të mbulojnë të gjitha fazat e veprimtarisë së auditimit të brendshëm. me qëllim analizimin e nivelit të zbatimit të indikatorëve të performancës. Ky program duhet të përcaktojë indikatorët e cilësisë së performancës.

Rekomandim: Drejtuesi i Auditimit të Brendshëm të hartojë çdo vit raport specifik mbi vlerësimin e performancës dhe rezultatet e sigurimit të brendshëm të cilësisë, i cili duhet të dërgohet për informacion tek Bordi Administrimit dhe Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, sipas përcaktimeve ligjore.

Rekomandim: Audituesit e Brendshëm, duhet të ndjekin në mënyrë të vazhdueshme plotësimin e pyetësorit të feedback-ut nga subjektet e audituara, si dhe plotësimin e komenteve në aneksin përkatës.

Opinion i grupit të vlerësimit për përputhshmërinë e veprimtarisë audituese me përcaktimet në Manualin e Auditimit të Brendshëm dhe plotësimin e kriterëve të Standardit 1300 thekson faktin se.

Sektori i Auditimit të Brendshëm në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës funksionon:

-  - E kuqe - në mospërputhje të plotë me standardin

• STANDARD ISSPA 2000 - MENAXHIMI I VEPRIMTARISË SË AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm duhet të menaxhojë me efektivitet veprimtarinë e auditimit të brendshëm, për të siguruar që kjo veprimtari shton vlerë në njësinë publike ku operon. Stafi i njësisë së auditimit duhet në mënyrë të vazhdueshme të përmbushë qëllimin dhe përgjegjësitë e përfshira në Kartën e Auditimit të Brendshëm, të veprojë në përputhje me standardet dhe Kodin e Etikës për Audituesit e Brendshëm, si dhe të marrë parasysh ndryshimet në njësinë publike.

Sektori i Auditimit të Brendshëm, si njësi e krijuar prej disa vitesh, me një eksperiencë në njohjen e sistemeve dhe fushave të veprimtarisë së njësisë publike, gjë që e ka ndihmuar atë në njohjen më të mirë të objektivave, sistemeve, fushave, aktiviteteve dhe proceseve të punës brenda çdo strukture/Departamenti/Drejtorie/Sektori në Universitetin e Durrësit, si subjekte auditimi, duke krijuar universin e auditimit.

I gjithë stafi i SAB ka eksperiencë në këtë institucion gjë që ka ndihmuar në njohjen e mirë të aktiviteteve dhe strukturës organizative të njësive subjekt auditimi. Pra universi i auditimit i

përcaktuar është i menaxhueshëm dhe i qëndrueshëm por jo gjithëpërfshirës sipas fushës së përgjegjësisë njësisë publike të përcaktuar në Ligjin 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Universi i auditimit është bërë prezent në Planin strategjik dhe vjetor 2020-2022, i cili është është dërguar në mënyrë elektronike në DH/AB.

Planin vjetor dhe strategjik i veprimtarisë së NJAB për vitin 2021-2023 është hartuar nga NJAB dhe është paraqitur në mënyrë elektronike në DH/AB pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Nga shqyrtimi i Planit strategjik dhe vjetor 2021-2023, objektivat e përcaktuara nga SAB në Universitetin e Durrësit, ishin të fokusuar tek:

- Programi dhe kryerja e auditimeve në bazë të planit të miratuar, duke ruajtur frekuencën e auditimit, vlerësimin e riskut dhe nivelin e materialitetit;
- Vlerësimi i sistemit të kontrollit të brendshëm dhe dhënia e rekomandimeve për vlerësimin e tij;
- Ndjekja në vazhdim të rekomandimeve të dhëna nga auditimet, në bazë të planit të miratuar për ndjekjen e tyre;
- Minimizimi i kostove të auditimit duke u përqëndruar në sistemet apo fushat me risk të lartë;
- Ndikimi dhe impakti i shkaktuar nga Covid 19 për ekspozimin e ri të riskut, rivlerësim të nivelit të riskut pasi vlerësimi aktual është bazuar në disa fusha, që tashmë janë të ndryshuara.

Në planin vjetor 2020 ishin parashikuar auditimi i 2 subjekteve përfshirë dhe drejtori të Universitetit të Durrësit.

Në planin vjetor 2021 ishin parashikuar auditimi i 7 subjekteve përfshirë dhe drejtori të Universitetit të Durrësit. Nuk ka të dhëna për ndryshim të planeve vjetore megjithëse këto plane nuk ishin realizuar.

Nga shqyrtimi i këtyre planeve evidentohet se kjo Njësi përgjithësisht është munduar të respektojë kërkesat në drejtim të standardeve që lidhen me hartimin e këtyre planeve. Megjithatë janë evidentuar mangësitë e mëposhtme:

- SAB nuk ka përfshirë në auditim të gjitha strukturat e varësisë (Fakultetet), si subjekte auditimi duke mos planifikuar pranë tyre auditimin për “Shërbimet e sigurisë” ose “Shërbime këshillimi”.
- SAB nuk administron të plotësuar formatet standard, Formatin nr. 1 “Pyetësor vlerësimi për mjedisin e kontrollit të brendshëm” dhe Formatin nr.2 “Pyetësor për Planin Strategjik”, si pjesë të procesit të planifikimit fillestar, për të identifikuar riskun e vlerësuar në çdo sistem apo nënsistem që do të auditohet.

Në këto dokumenta, Drejtuesi i NJAB kishte përcaktuar objektivat afatshkurtër, të cilat ishin të orjentuara:

- a. në planifikimin e subjekteve me frekuencë më të gjatë pa audituar,
- b. tek subjektet, ku mundësia e ndodhjes së riskut është e lartë,
- c. në fokusimin e vlerësimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm, menaxhimit të riskut dhe proceseve të qeverisjes.

Realizimi i planit vjetor 2020.

- Në vitin 2020 ishin parashikuar gjithsej 2 angazhime auditimi, për shërbimet e sigurisë, një auditim përputhshmërie dhe një auditim financiar dhe në fakt është realizuar 1 angazhim auditimi (a.përputhshmërie). Kjo për shkak të periudhës së vështirë të ardhur nga Pandemia Globale. Por kjo nuk pengonte SAB të bënte rishikim të planit vjetor. Situata e vështirë, nga

Covid-19 është bërë prezent dhe në rubrikën “Analiza e programeve të auditimit” në Raportin Vjetor 2020 të veprimtarisë së SAB, ku theksohet pamundësia e realizimit të këtyre auditimeve.

Realizimi i planit vjetor 2021

- Në vitin 2021 ishin parashikuar gjithsej 7 angazhime auditimi, për shërbimet e sigurisë, 1 a.përputhshmërie, 1 a.financiar dhe 5 Auditime të kombinuara dhe në fakt janë realizuar 5 auditime, 1 a.përputhshmërie dhe 4 të kombinuara. SAB nuk ka përgatitur për miratim argumentimin e rishikimit të planit vjetor.

Grupi i vlerësimit evidenton se gjatë të dy viteve të vlerësimit nga ana e strukturës së auditimit nuk është bërë ndryshim plani.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të kësaj praktike, evidentojmë që nga grupet e auditimit në përgjithësi zbatohen afatet e raportimit të angazhimeve të auditimit. *Trajtuar më gjerësisht në Standardin 2400*

Gjatë hartimit të planeve strategjike dhe vjetore është evidentuar se audituesit nuk marrin në konsideratë regjistrin e riskut, si dhe në njësitë publike në të cilat ky regjistër nuk ishte hartuar ose nuk ishte përditësuar rregullisht, në mënyrë të vazhdueshme duhet të adresoheshin rekomandime për hartimin e tij.

Gjatë vitit 2020-2021, nga shqyrtimi i dokumentacionit të angazhim auditimeve të kryera për periudhën objekt vlerësimi u konstatua se për të gjitha angazhimet e kryera ishin diskutuar me titullarin si në fazën e miratimit të planit.

Nga bashkëbisedimi me stafin e SAB u pohua se mbas hartimit të Planit strategjik dhe vjetor i është dërguar me shkresë titullarit për miratim, por jo për të dy vitet objekt vlerësimi këto dokumenta janë miratuar.

Formati standard për vlerësimin e riskut të sistemit fushës që do të auditohej në angazhimet e auditimit të shqyrtuara përmbante analizimin e faktorëve për identifikimin e risqeve në fusha specifike, si dhe të kriterëve për vlerësimin e nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët) në të gjitha dosjet e paraqitur për vitin 2020-2021.

Në dosjet e shqyrtuara (viti 2020-2021) u konstatua se në raportet e hartuara për çdo angazhim auditimi nuk shprehej opinionin e grupit lidhur me faktorët që kanë çuar në:

- nivelin e riskut të evidentuar;
- vlerësimin e përshtatshmërisë dhe efektivitetin e kontroleve të brendshme të vendosura.

Në këto raporte nuk ishin vlerësuar komponentët e KB, pra nuk kishte analizë të plotë për secilin komponent të kontrollit të brendshëm dhe nuk ishin evidentuar saktë mangësitë e vërejtura, kjo për të dhënë të qarta rekomandimet për të ardhmen dhe opinion të përgjithshëm për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

Opinion i përgjithshëm për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm duhet të jetë present si në përmbledhësen ekzekutive dhe në memorandumin e çdo raporti angazhimi. *Trajtuar më gjerësisht në Standardin 2400*

Nga shqyrtimi i Planeve strategjike dhe vjetore 2020-2022, dhe 2021-2023, të cilët nuk janë miratuar nga Titullari dhe janë dorëzuar zyrtarisht në DH/AB janë parashikuar të auditohen për periudhë 3-vjeçare të gjitha fushat/sistemet duke iu dhënë prioritet sistemeve sipas nivelit të riskut (të lartë, të mesëm, të ulët).

Grupi i vlerësimit pas shqyrtimit të dokumentacionit që disponoi konstaton se për periudhën objekt vlerësimi plani për vitin 2020 dhe 2021 megjithëse ka përsuar ndryshime, evidentohet se këto ndryshime nuk janë të miratuara nga Titullari. *Trajtuar më gjerësisht në Standardin 2200.*

Në Raportin Vjetor të veprimtarisë së auditimit të brendshëm për vitin 2021 janë analizuar burimet njëjësore të SAB dhe Kapitullin VII “Kapacitetet audituese” evidentohet se gjatë vitit 2021 kjo strukturë dhe nuk ka pasur problem me burimet, aktualisht kjo strukturë është e plotësuar. .

Në Kapitullin VIII “Konkluzione” theksohet se: *“Mosrealizimi në kohë i aktiviteteve për vitin 2020, janë për shkak të gjendjes së pazakontë në vend nga COVID 19. Kjo ka cuar në mosrealizimin e plotë të planit të auditimeve, sipas përcaktimeve në Manualin e Auditimit të Brendshëm”*

Nga grupi i vlerësimit evidentohet se audituesit kanë aftësi profesionale dhe njohuri të mjaftueshme për identifikimin e riskut të mashtrimit dhe njohuri bazë në teknologjinë e informacionit, por në asnjë rast nuk është kërkuar përfshirja e ekspertëve të jashtëm me njohuri në fusha specifike në grupet e auditimit.

Drejtuesi i NJAB ka vlerësuar burimet në dispozicion dhe ka trajtuar në Kapitullin VII komunikuar “Analiza e kapaciteteve audituese” në “Raportin e veprimtarisë për vitin 2021”, miratuar nga Bordi me Vendim nr.17/1, datë 24.03.2022 dhe dërguar zyrtarisht në DH/AB në MFE nr.275/1, datë 24.03.2022. Në këtë dokument nuk evidentohen problematika lidhur me burimet njëjësore. “... Për periudhën raportuese struktura e AB është e plotësuar.

Kjo NJAB nuk përfshin në grupe auditimi punonjës jo-auditues nga struktura e Universitetit të Durrësit ose e subjekteve në varësi të kësaj strukture.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit në dosjet e angazhimeve të përzgjedhura rezulton se procedurat e përdorura janë të përshtatshme. Procesi i përditësimit të dokumentacionit, formatet standard janë pjesë e dosjes, por testet dhe vlerësimi i brendshëm i cilësisë nuk është kryer nga çdo grup auditimi

Për periudhën objekt vlerësimi, Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës është audituar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. Në këto kushte vlerësohet se respektohet dhe mbështetet puna e audituesve të brendshëm nga KLSH.

Evidentohet se Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës ka përgatitur dhe miratuar Regjistrin e Riskut të njësisë publike për periudhën 2020-2021. Ky regjistër ishte pjesë e dokumenteve strategjike të UD dhe Njësia e auditimit si pjesë integrale e njësisë publike kishte përfshirë risqet specifike të veprimtarisë audituese në këtë dokument.

SAB njeh detyrimin e vlerësimit në mënyrë të vazhdueshme të punës së ofertuesve të tjerë të jashtëm të shërbimeve të sigurisë, (KLSH) duke koordinuar veprimtarinë për të shmangur mbivendosjet për auditimin e planifikuar pranë Aparatit të Institucionit, si dhe institucioneve vartëse. Për periudhën objekt vlerësimi kjo NJAB nuk ishte audituar nga KLSH

Nga dokumentacioni i vlerësuar është evidentuar se drejtuesi i NJAB ka raportuar periodikisht në mënyrë zyrtare tek titullari i njësisë publike. Referuar planeve strategjike dhe vjetore, raportet vjetore të veprimtarisë dhe raportet angazhimeve.

Sa trajtuar më sipër grupi i vlerësimit rekomandon:

Rekomandim: Drejtuesi i NJAB në vazhdim të veprimtarisë të përgatisë plane strategjike dhe vjetore duke përcaktuar qartë qëllimin, objektivat, duke identifikuar e vlerësuar risqet, sistemet/fushat me risk që do të auditohen, etj. sipas përcaktimeve në Manualin e Auditimit të Brendshëm, të ndryshuar,

si dhe të respektojë afatet e përcaktuara për miratimin dhe dërgimin e këtyre dokumentave në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në MFE.

Rekomandim: Drejtuesi i NJAB të përfshijë në planifikimin strategjik dhe vjetor të veprimtarisë të auditimit jo vetëm vlerësimin e shërbimeve administrative pranë Universitetit të Durrësit, por dhe vlerësimin e të gjitha sistemeve (Fakultetet), sisteme të cilat mbartin risk të lartë, kanë nevojë për përmirësim dhe që bëhen pengesë për arritjen e objektivave.

Rekomandim: Drejtuesi i NJAB për çdo rishikim të planit vjetor të përgatisë argumentimin e bazuar të ndryshimeve dhe pas miratimit nga Bordi i Administrimit, të dërgojë këtë dokument për njoftim në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm për realizimin e veprimtarisë audituese në përputhje me standardet ndërkombëtare, të pranura.

Opinion i grupit të vlerësimit për përputhshmërinë e veprimtarisë audituese me përcaktimet në Manualin e Auditimit të Brendshëm dhe plotësimin e kriterëve të Standardit 2000 thekson faktin se:

Spektori i Auditimit të Brendshëm në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës funksionon:

- ☐ - E verdhë - në përputhje në disa fusha me standardin, por kërkohen përmirësime të nevojshme në fushat ku janë adresuar rekomandime.

• STANDARD 2100 - NATYRA E PUNËS

Qëllimi i këtij standardi është që veprimtaria e auditimit të brendshëm të kontribuojë në përmirësimin e proceseve të qeverisjes, menaxhimit e riskut dhe proceseve të kontrollit, për realizimin e objektivave të njësisë publike.

Nga dokumentacioni i vlerësuar, evidentohet që Spektori i Auditimit të Brendshëm, procesin e monitorimit dhe ndjekjes së rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme, nuk e njeh si një praktikë pune, se si duhet të kryhet gjatë zhvillimit të auditimit, për sa kohë që kjo strukturë nuk kryen misionë angazhim auditimi të bazuara në Manual dhe standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm.

Në pikën 4.1 të Kapitullit IV të MAB “Kryerja e Auditimit të Brendshëm, ndjekja e procedurave dhe raportimi e komunikimi i auditimit”, përshkruhet skema e auditimit, sipas fazave të tij, që nga planifikimi i angazhimit, puna në terren, raportimi dhe ndjekja e rekomandimeve. Mbështetur në kërkesat e manualit, vlerësojmë se audituesit e këtij institucioni të arsimit të lartë publik, verifikimin mbi zbatimin e rekomandimeve të dhëna, duhet ta marrin në shqyrtim në auditimin e radhës, duke e përfshirë këtë çështje, si drejtim të veçantë në programin e angazhimit të auditimit të subjektit, “zbatimi i rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm”.

Në këtë drejtim duhet të analizohet statusi i gjithë rekomandimeve të adresuara, sa janë zbatuar, çfarë masash janë ndërmarrë nga subjekti për zbatimin e tyre, sa prej tyre janë në proces zbatimi, çfarë pengesash janë evidentuar në procesin e implementimit të tyre, sa rekomandime nuk janë zbatuar dhe cilat janë arsyet e mos zbatimit të tyre, etj.

Konstatohet se audituesit e brendshëm, nuk kanë kryer monitorim të vazhdueshëm të këtij procesi, në fund të çdo viti kalendarik, duke mos ndërmarrë një angazhim të bazuar në një program me objekt “Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme”, si një kërkesë e ligjit nr.114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” neni 12, pika d) dhe neni 14, pika iv), Manualit të Auditimit të Brendshëm, pika 4.1.13 “Ndjekja e rekomandimeve”, si dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.42, datë 27.10.2020 “Mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga AB në sektorin publik”.

Mbështetur në evidencat e raportuara, konstatohet se SAB për vitin 2021, me raportin vjetor dërguar me shkresë nr.275/1, datë 24.03.2022, ka raportuar sipas (pasqyrës 5) se nga 5 rekomandime të dhëna gjithsej, të gjitha rekomandimet janë zbatuar, ndërsa rekomandime në proces zbatimi nuk ka.

Duke ju referuar pikës 4.1.13.2 dhe 4.1.13.3 të MAB “Përgjegjësia e njësisë për të zbatuar rekomandimet e AB”, si dhe në faktin që rekomandimet e adresuara kanë të bëjnë me fusha dhe sisteme të cilat duhet të vlerësohen me nivele të larta risku dhe prioriteti, u vërejt se rekomandimet mbi përmirësimin e sistemeve (prokurimet), apo ato me karakter organizativ, apo arkëtim etj, janë zbatuar nga strukturat të cilave ju janë adresuar, por në këtë aspekt mbetet akoma punë për të bërë, pasi numri i rekomandimeve sipas evidencës së raportuar është shumë i ulët në raport me madhësinë dhe kompleksitetin e veprimtarisë ose transaksioneve që kryhen nga Universiteti i Durrësit, gjatë një periudhe ushtrimore të caktuar.

Si përfundim, u konstatua se nga drejtuesit e drejtorive/degëve dhe Fakulteteve të audituara nuk janë kryer raportime për zbatimin e rekomandimeve, sepse në raportet përfundimtare të përcjella nuk janë shoqëruar me formatin e planveprimt mbi zbatimin e tyre, në kuadër të përcaktimit ligjor për të raportuar mbi ecurinë dhe progresin që është bërë në këtë drejtim.

U vërejt se NJAB ka hartuar regjistrin e riskut (si pjesë e regjistrit të riskut të Universitetit të Durrësit), në të cilin janë dhënë përshkrimet e llojit të riskut, kontrollet ekzistuese, si dhe veprimet për të adresuar boshllëqet. Nga vlerësimi i dosjeve të shqyrtuara u konstatua se:

- AB kanë plotësuar formatet standard nr.4, nr.5 për sistemet e audituara gjatë fazën përgatitore, punës në terren.
- shkresa “njoftimi mbi auditimin”, ku i bëhej me dije subjektit për fillimin e misionit të auditimit, së bashku me pikat e “programit”, si dhe baza ligjore respektive, nuk mund të konsiderohet si një program angazhimi auditimi i mirëfilltë, sepse duhet të ishte përcaktuar më parë fushëveprimi për të arritur objektivat, ku gjatë kësaj faze nga AB rishikohen funksionimi i kontrolleve të brendshme, dhe pasi përcaktohen sesi duhet të funksionojë sistemi/fusha që do të auditohet, atëherë përgatitet programi i angazhimit
- programi, duhet të përfshirë si drejtim auditimi të gjitha sistemet e vlerësuara në bazë të riskut, përmendim këtu sidomos parashikimin për vlerësim të komponentëve të kontrollit të brendshëm, si një nga drejtimet kyçe për vlerësimin dhe menaxhimin e riskut. Ndërkohë që grupi i auditimit, duhet të ishte referuar tek komponentët, si: mjedisi i kontrollit, menaxhim risku, veprimtaritë e kontrollit, informacioni dhe komunikimi, monitorimi, duke e paraqitur ato jo vetëm në program, por edhe si drejtime auditimi në raportet e shqyrtuara nga grupi i vlerësimit- grupi i auditimit.
- Në raporte nuk shqyrtohet ekzistenca dhe plotësia e regjistrit të riskut apo mungesa e rregulloreve të funksionimit nga strukturat e audituara, duke mosrekomanduar masa për hartimin e tyre, si mjete parandaluese të veprimeve të parregullta që mund të ndodhin me ndikim në cënimin e arritjes së objektivave të vendosura në UAMD.

Grupi i vlerësimit në bashkëbisedim me audituesit e NJAB në Universiteti i Durrësit konstaton se pavarësisht se AB njohin funksionimin e sistemeve dhe proceseve të punës brenda strukturave të Universitetit, atyre nuk ju ka munguar gjykimi për të bërë vlerësimin e fushave, ku risku për mashtrim është i mundshëm të shfaqet që në fazën e planifikimit, përpos njohurive ligjore që ata kanë, sidomos me reagimin që duhet të ndërmarrin në të tilla raste.

Nga vlerësimi i dosjeve të shqyrtuara u konstatua se grupi i auditimit:

- ka hartuar pyetësorët përkatës (4 dhe 5) vlerësimit të riskut për mjedisin e përgjithshëm të kontrollit për të testuar gjëndjen e proceseve e kontrolleve ekzistuese;

- ka dokumentuar pyetësorët mbi vlerësimin e funksionimit dhe efikasitetin e sistemit të inventarëve fizikë dhe kontabël, menaxhimit të aktiveve afatshkurtra, sipas parashikimeve në dokumentacionin e procedurave, për të identifikuar përparësitë apo dobësitë e tyre.
- vërehet se dosjet e auditimit, nuk përmbajnë mjaftueshëm letra pune nëpërmjet të cilave gjurmohet, evidentohet procedura në përzgjedhjen që duhet të bëjë audituesi për kryerjen e “testeve” tek sistemet, të cilat duhet të jenë në formë tabele, ku të përshkruhet proceset e kontrollit në çdo fazë të tij, për të konfirmuar e siguruar se janë ndjekur të gjitha proceset e pritshme.

Në referencë me kërkesat e kapitullit IV të MAB, audituesit e brendshëm, në linjë me fushëveprimin dhe objektivat e auditimit në Universitetin e Durrësit, duhet të përgatitë disa nga testet e auditimit të brendshëm, si: në drejtim të verifikimit të shpenzimeve korente, pagave shpenzimeve të personelit, përdorimit të të ardhurave dytësore, verifikimit të realizimit të procedurave të investimeve, prokurimit të fondeve publike, etj.

Në raportet e auditimit, nuk evidentohen përshkrime të detajuara ku të jenë shqyrtuar sistemet kryesore të kontrollit të brendshëm, për të bërë një vlerësim të tyre, pasi në bazë të gjetjeve duhet të adresohen dhe rekomandime, në lidhje me efektivitetin, përshtatshmërinë e tyre, me qëllim për të dhënë një opinion mbi këto rezultate, i cili duhet të evidentohet: *(tek përmbledhja ekzekutive dhe në vijim pas çdo sistemi apo fushe të audituar në raportin e auditimit)*. Nga shqyrtimi i raporteve vërehet se grupit të audituesve në Universitetin e Durrësit, nuk ju është kërkuar nga Bordi i Administrimit, të ofrojnë shërbime këshillimi për procese apo sisteme të vlerësuara me risk të lartë.

Nga vlerësimi i raporteve, konstatohet se ato kanë mangësi në përmbushjen e disa prej standardeve e kërkesave të përcaktuara në MAB, sepse duhet që pas paraqitjes së gjetjeve, parregullsive dhe rekomandimeve, audituesit të japin një konkluzion apo vlerësim të përgjithshëm, tek (Përmbledhja Ekzekutive), mbi funksionimin e sistemeve të ngritura në subjekt, nëse këto sisteme janë efektive dhe të përshtatshme për zbatim nga të gjithë strukturat apo punonjësit e subjektit të audituar. Në lidhje me me rezultatet e dala nga vlerësimi i sistemeve dhe kontrolleve, theksojmë se Bordi i Administrimit duhet të njihet me to, nëpërmjet formulimit të një dokumenti “Memo”, *(një përmbledhje e shkurtër e raportit final të auditimit)*, ndërkohë që misioni dhe roli i auditimit të brendshëm është të japë mbështetje titullarit të strukturës së audituar në arritjen e objektivave, për të vlerësuar përshtatshmërinë dhe efektivitetin e sistemeve dhe kontrolleve

Nga grupi vlerësimi evidentohet se audituesit e brendshëm të Universitetit të Durrësit ofrojnë siguri të arsyeshme, lidhur me besueshmërinë në përdorimin e dokumentacionit të shqyrtuar vetëm për qëllimet e auditimit, konfirmuar nga pohimi se në asnjë rast nuk është evidentuar pretendim për mungesë të aksesit në dokumentacion, informacion dhe punonjës.

Gjatë intervistimit u pohua se audituesit i kushtojnë vëmendje respektimit të parimit të ruajtjes së konfidencialitetit të dokumentacionit të shqyrtuar në raport me detyrimin ligjor për këtë çështje.

Sa trajtuar më sipër grupi i vlerësimi rekomandon:

Rekomandim: Në raportet e hartuara në përfundim të çdo angazhimi, grupi i auditimit duhet të plotësojë opinionin e përgjithshëm me terma konkretë lidhur me funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në subjektet e audituara, si dhe nivelin e riskut të përcaktuar në përfundim të angazhimit auditimit me qëllim vlerësimin e performancës së subjektit gjatë dy auditimeve të njëpasnjëshme.

Rekomandim: Audituesit e brendshëm në raportet e auditimit të hartuara, të pasqyrojnë shqyrtimin e regjistrit të riskut të njësisë së audituar, si dhe të adresojnë rekomandime konkrete për hartimin e regjistrit të riskut, apo rishikimit të tij kur risku është rritur si dhe kur aktivitetet e kontrollit të vendosura nuk janë të mjaftueshme për minimizimin e tij.

Opinion i grupit të vlerësimit për përputhshmërinë e veprimtarisë audituese me përcaktimet në Manualin e Auditimit të Brendshëm dhe plotësimin e kriterëve të Standardit 2100, thekson faktin se:

Spektori i Auditimit të Brendshëm në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës funksionon:

-  - Portokalli - në përputhje me disa fusha me standardin, por kërkohen përmirësime të domosdoshme në fushat ku janë adresuar rekomandimet.

• STANDARD 2200 - PLANIFIKIMI I ANGAZHIMIT

Audituesit e brendshëm duhet të hartojnë program për çdo angazhim, në të cilin duhet të përfshihen objektivat, fushat/sistemet, koha dhe shpërndarja e burimeve. Programi duhet të bazohet në strategjitë e njësisë publike, objektivat dhe risqet e lidhura me angazhimin.

Nga vlerësimi i dosjeve të shqyrtuara u konstatua se, për çdo mision auditimi, SAB ka hartuar një dokument në formë “Program Angazhim Auditimi”, i cili sipas standardit duhet të jetë nënshkruar nga gjithë grupi i auditimit, dhe jo vetëm nga drejtuesi i NJAB. Programi i angazhimit nuk është konform (formatit standard nr.8) të MAB, por në përmbajtjen e tij, vërehen shumë elementë që përfshijnë disa nga rubrikat e përcaktuara, si: objektin, llojin e auditimit, subjektin që auditohet, periudhën objekt auditimi, afatin e auditimit, qëllimin e auditimit, grupin e auditimit, drejtimet e tij dhe bazën ligjore. Për përgatitjen e çdo programi, duhet të sigurohet paraprakisht i gjithë informacioni i nevojshëm, mbi funksionet dhe proceset që janë pjesë e aktivitetit të subjektit të audituar dhe fushat me risk të lartë.

Standardi-2200, mbi hartimin e programeve të auditimit, kërkon që të përcaktohet qartë lloji i auditimit (sipas përcaktimeve në planin vjetor të miratuar) dhe metoda e auditimit, që audituesi i brendshëm do të përdorë gjatë zhvillimit të angazhimit, sipas përcaktimit në kapitullin V “Metodat dhe teknikat” të MAB. Në dosjet e shqyrtuara evidentohet që nuk janë të përcaktuara metodat e auditimit.

Përveç të tjerave, kërkohet që një program angazhimi, për të plotësuar kërkesat e MAB duhet të ketë të mirë përcaktuar edhe fushëveprimin e auditimit, sidomos drejtimet e auditimit, periudhën e vlerësuar, sistemet, përcaktime të cilat duhet të jenë në përputhje të plotë me standardet dhe pikën 4.1.6 të MAB.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit në dosjet e vëna në dispozicion u vlerësua se SAB kishte përcaktuar objektivat në çdo angazhim auditimi (të cilat nuk ishin specifike), si dhe elementët që i shërbenin kryerjes së fazës parapërgatitore ishin plotësuar formatet standard të vlerësimit të riskut (Formati nr.4 “Vlerësimin e riskut të mjedisit të përgjithshëm të kontrollit”, Formatin nr.5 “Vlerësimin e riskut për sistemin/fushën që do të auditohet”, si dhe Formatin i vlerësimit të përgjithshëm të riskut).

Por, konstatohet se në dosjet e punës nuk ishin të plota të gjitha testet dhe pyetësorët përkatës, lidhur me verifikimin paraprak të gjëndjes dhe funksionimit të proceseve e sistemeve ekzistuese, në funksion të arritjes së objektivave të auditimit, prandaj vlerësojmë se qëllimi i përgatitjes së testeve të auditimit nga grupi i punës, ju shërben për gjurmimin apo verifikimin e një veprimi/transaksioni/proçesi sipas fazave, nëpër të cilat ai kalon, përkundrajt parashikimeve ligjore e proceduriale të dokumentacionit.

Sa më sipër, theksojmë se audituesit me anë të testimit vëzhgon sistemin, ku vlerëson se procesi aktual, sistemi, raportet, transaksionet etj, janë kryer siç duhet dhe punonjësi që i kryen këto procese pune ka zbatuar detyrat dhe përgjegjësitë në përputhje me rregulloren e brendshme dhe përshkrimin e punës, mirëpo dosjet nuk administrojnë listën e sistemeve të përzgjedhura për vlerësim të shoqëruara me shënime përkatëse, të plotësuara gjatë punës në terren.

Nga intervistimi i kryer u konstatua se audituesit e brendshëm të NJAB, kanë një eksperiencë pune prej disa vitesh në auditim, që nënkupton se ata kanë njohuri mbi sistemet e kontrollit të brendshëm tek strukturat që auditojnë, të cilat në gjykimin profesional të tyre, përqendrohen tek fushat e konsideruara me risk të lartë, sidomos te sistemi i të ardhurave nga tarifat e cikleve të studimit, sistemi i prokurimeve dhe investimeve, sistemi i detyrimeve të prapambetura, sistemi i pagave dhe shpërblimeve; sistemi i administrimit të pronave, shitjes dhe qiradhënies, etj, për të vlerësuar sa më drejt mundësisë së ndodhjes së gabimeve, ose mashtrimeve, veprime të cilat duhet të bëhen përpara se të hartohet programi i angazhimit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit në dosjet e përzgjedhura konstatohet se NJAB, i ka përcaktuar objektivat për çdo auditim (të cilat nuk janë specifike), por duke mos shfrytëzuar plotësisht të gjithë informacionet mbi rezultatet vjetore të vlerësimit të riskut, të cilat dalin gjatë fazës përgatitore për çdo angazhim.

Nuk sigurohet informacion i plotë mbi mënyrën se si janë miratuar planet strategjike dhe vjetore për periudhat objekt vlerësimi, përkatësisht shkresat me të cilat janë dërguar në rrugë elektronike këto plane janë pa numër protokolli dhe nuk kanë vulë zyrtare të institucionit të Universitetit të Durrësit.

Nga verifikimi i Planit Strategjik 2021-2023 dhe Vjetor 2021, ku përveç plotësimit të standardeve përkatëse janë konstatuar edhe disa parregullsi:

- plani strategjik e vjetor 2021 nuk është strukturuar konform formatit të parashikuar në metodologjinë e hartimit të Planit Strategjik dhe Vjetor, të Manualit të Auditimit të Brendshëm.
- identifikimi dhe vlerësimi i risqeve, tek pasqyra nr.1 "Vlerësimi i nivelit të risqeve për të gjithë subjektet që do të auditohej nga NJAB" është plotësuar për 3 vitet e planit strategjik, në fakt metodologjia përcakton se duhet të paraqiten rezultatet e vlerësimit të riskut, sipas niveleve, për të gjitha subjektet/strukturat ku NJAB ka detyrimin për auditim, por jo çdo vit.
- subjektet për tu audituar si tek pasqyra 1 dhe pasqyra 3 (kolona 1) janë të njëjtat emërtesa e subjekteve për tu audituar sipas nivelit të riskut, si për vitin 2023 ashtu edhe për vitin 2021, kur në fakt UAMD ka edhe subjekte të tjera si detyrim për tu audituar gjatë kësaj periudhe, të cilat nuk janë parashikuar në tabelën përkatëse.
- Në pjesën shpjeguese të planit vjetor 2021, nuk bëhet shpjegimi mbi kryerjen e procesit të sigurimit të brendshëm të cilësisë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit në dosjet konstatohet se:

- ✦ NJAB tregon kujdesin e duhur profesional për informimin e drejtuesit të strukturës së audituar, në lidhje me angazhimin e ardhshëm të auditimit, nëpërmjet shkresës "Për fillimin e misionit të auditimit",
- ✦ Nuk është dokumentuar takimi fillestar, me organizatën, i cili ka qëllim prezantimin e objektit dhe objektivave të auditimit, veçanërisht ato specifike për sistemet/proceset, të cilat do të auditohej, hapat dhe fazat e procesit të auditimit, linjat e komunikimit midis grupit të auditimit, menaxhimit dhe stafit të njësisë që auditohej, si dhe përcaktimi i informacionit që vlerësohet i nevojshëm për kryerjen e auditimit.
- ✦ Standartet dhe kërkesat e MAB, përcaktojnë se pas përfundimit të fazës "Puna në terren", audituesit në respektim të parimeve të komunikimit të rezultateve duhet të zhvillojnë takimin përmbyllës, ku prezantohen gjetjet e evidentuara, shpjegimet e bëra nga audituesi, si dhe të strukturës së audituar, mbi argumentimin e gjetjeve, si dhe reagimet nëse ka ndaj rekomandimeve të dhëna, takim i cili nuk është kryer praktikisht nga palët respektive.

Nga dosjet e shqyrtuara, vërehet se fushëveprimi i auditimit ka qenë i pamjaftueshëm, për të arritur objektivat e auditimit. Në fushëveprimin e auditimit janë përfshirë sistemet/fushat me risk të lartë,

qasjet e audituesit mbi të dhënat e asetet, dokumentet, informacionet dhe burimet njerëzore në dispozicion që lidhen me objektivat e auditimit, por evidentohet që në planifikim nuk janë përfshirë vlerësimi i sistemeve në Fakultetet e Universitetit të Durrësit.

Burimet njerëzore të NJAB, në periudhën objekt vlerësimi, janë përdorur në përputhje me planifikimin. Numri i planifikuar i misioneve të auditimit është bërë duke patur parasysh strukturën e miratuar, me 1 Përgjegjës Sektori dhe 2 specialistë.

Audituesit e brendshëm janë të diplomuar në degën “Ekonomi”, kanë ndjekur trajnimet e organizuara në fushën e auditimit, si dhe nuk është parashikuar përfshirja në grupin e auditimit të ekspertëve të jashtëm jo-auditues me njohuri në fusha specifike.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, vërehet se për çdo angazhim të planifikuar, ishte hartuar një program angazhimi, ku aty duhet të përcaktoheshin qartë drejtimet kryesore të tij, si dhe metodat e auditimit, bazuar në Manualin e AB, të ndryshuar.

Bazuar te standartet e AB, kërkesat metodologjike të parashikuara në MAB, vlerësojmë se nga NJAB, duhet të përcaktojnë metodat dhe teknikat e auditimit, por jo vetëm në procesin e programimit, por edhe gjatë kryerjes së punës në terren dhe të pasqyrohen qartë në raportin përfundimtar të auditimit.

Në dosjet e auditimit nuk ka ndarje të detyrave për çdo anëtar të grupit të auditimit dhe ky proces nuk dokumentohet.

Për periudhën e vlerësuar nuk ka pasur raste të kërkuara për shtyrjen e afatit të kryerjes së angazhimit, sepse SAB nuk i ka tejkaluar afatet ligjore të kohës së kryerjes së auditimit.

Sa trajtuar më sipër grupi i vlerësimit rekomandon:

Rekomandim: Audituesit e brendshëm të përcaktojnë objektiva të specifikuara për çdo angazhim auditimi të cilat të pasqyrojnë vlerësimin paraprak të riqeve të veprimtarisë që auditohet, për të siguruar menaxhimin e subjektit të audituar se ka vendosur kontrolle të mjaftueshme, të përshtatshme dhe efektive për realizimin e objektivave të veprimtarisë, si dhe për të mbajtur risqet e identifikuara në nivele të pranueshme.

Rekomandim: Audituesit e brendshëm në çdo program auditimi të përfshijnë vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, nëpërmjet analizimit të pesë komponentëve, si drejtim i rëndësishëm për vlerësimin e riskut, miratimin dhe monitorimin e strategjisë për menaxhimin e risqeve brenda subjekteve të audituara.

Opinionin e grupit të vlerësimit për përputhshmërinë e veprimtarisë audituese me përcaktimet në Manualin e Auditimit të Brendshëm dhe plotësimin e kriterëve të Standardit 2200, thekson faktin se:

Sektori i Auditimit të Brendshëm në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës funksionon:

 - E gjelbër - në përputhje të plotë me standardin

• STANDARD 2300 - KRYERJA E ANGAZHIMIT

Audituesit e brendshëm për çdo angazhim auditimi duhet të identifikojnë, analizojnë, vlerësojnë dhe dokumentojnë informacion të mjaftueshëm për të arritur objektivat e angazhimit.

Në interpretim të këtij standardi, për të arritur në konkluzione për vlerësimin e përshtatshmërisë së kontrolleve të brendshme të vendosura në fushën/sistemin që do të auditohet, si dhe për t'u siguruar se risqet për arritjen e objektivave të veprimtarisë ishin në nivele të pranueshme audituesit e brendshëm duhet të zhvillojnë opinionin dhe gjykimin e tyre bazuar në vlerësimin e gjetjeve e konstatimeve.

Nga shqyrtimi i dosjeve të auditimeve, u konstatua se gjatë angazhimit janë mbledhur të dhëna për të përfituar informacion mbi objektivat, proceset e punës, aktivitetet dhe sistemet që do të auditohen, mbi mjedisin e jashtëm dhe të brendshëm, të cilat duhet të konsiderohen gjatë punës në terren, nëpërmjet metodave të auditimit dhe që nuk janë të përcaktuara jo vetëm në program, por edhe në Raportet e Auditimit, të cilat gjykohen se janë më të përshtatshme dhe më të besueshme për subjektin, duke i analizuar e vlerësuar në funksion të arritjes së objektivave të angazhimit.

Në programet e auditimit nuk parashikohen metodat e auditimit, sipas përcaktimit të MAB, fakt që konstatohet edhe në raportet e auditimit, ku nuk ka rubrikë në të cilën evidentohet se cila nga metodat është zbatuar në praktikë, si e vlerësuar si më të përshtatshme për realizimin e auditimit me efektivitet dhe efikasitet.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit pjesë e dosjeve të përzgjedhura u konstatua se dosjet nuk përmbajnë letra pune apo evidenca të përshtatshme, të cilat duhet të lidhen me gjurmën që ato duhet të përcaktojnë mbi proceset e ndjekura për zbatimin e programit të auditimit. Evidencat e auditimit krijohen nëpërmjet informacioneve të marra gjatë punës në terren, rishikimit të dokumenteve thelbësorë mbi risqet, sistemet/fushat e përzgjedhura, dokumenta nga të cilat audituesit nxjerrin konkluzionet dhe mbështesin dhënien e opinionit. Në komunikimin e zhvilluar me audituesit pohohet se tregohet kujdes për respektimin e konfidencialitetit të të dhënave dhe dokumentacionit që aksesojnë për shkak të detyrës jo vetëm si detyrim ligjor, por edhe etik.

Nga shqyrtimi i dosjeve të përzgjedhura u vlerësua se me përfundimin e procedurave, audituesit kanë bërë sistemimin dhe mbylljen e dokumenteve në dosjen e auditimit, sipas dispozitave ligjore.

Në vijim sa është trajtuar tek Standardi 1300, grupi i vlerësimit, konstaton që procesin vlerësimit të brendshëm të cilësisë, kjo strukturë audituese nuk e kryen në asnjë nga mënyrat e përcaktuara në MAB.

Procesi i vlerësimit të brendshëm të cilësisë duhet dokumentuar sipas formateve të miratuara, të cilat duhet të jenë pjesë e Programit të Sigurimit të Cilësisë, të cilat mbas hartimit dhe miratimit duhet të administrohen në çdo dosje të angazhimit të auditimit.

Arkivimi i dokumentacionit të dosjeve të auditimeve të realizuara ishte kryer rregullisht.

Opinion i grupit të vlerësimit për përputhshmërinë e veprimtarisë audituese me përcaktimet në Manualin e Auditimit të Brendshëm dhe plotësimin e kriterëve të Standardit 2300, thekson faktin se:

Spektori i Auditimit të Brendshëm në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës funksionon:

-  - E gjelbër - në përputhje të plotë me standardin.

• STANDARD 2400 - KOMUNIKIMI I REZULTATEVE

Audituesit e brendshëm në mënyrë të vazhdueshme duhet të komunikojnë rezultatet e angazhimeve. Komunikimet e rezultateve duhet të jenë të sakta, objektive, të qarta, konçize, konstruktive, të plota dhe në kohë.

Grupi i vlerësimit, pas shqyrtimit të raporteve, konstaton se NJAB nuk ka respektuar strukturën formale të tyre, sipas përcaktimeve në pikën 4.1.12 “Raportet e auditimit dhe plotësimi i planveprimt nga njësia e audituar” të Manualit të AB (për periudhën 01.01.2020-01.09.2020), si dhe formatin e ri të raportimit, miratuar me Urdhër nr.4, datë 10.01.2020 “Për miratimin e disa shtesave dhe

ndryshimeve në Manualin e Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin nr.100, datë 25.10.2016”, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë (për periudhën 01.09.2020 e në vazhdim).

Mbështetur në kërkesat e MAB, projekt-raporti dhe raporti përfundimtar, duhet të kenë strukturën përkatëse, si: përmbledhje ekzekutive, hyrje; metodat e auditimit, gjetjet konkluzionet dhe rekomandimet. Vlerësojmë se në zbatim të standarteve të auditimit, grupi i auditimit për çdo sistem të vlerësuar duhet të pasqyrojë gjetjet dhe rekomandimet përkatëse, si një reflektim midis gjetjes/konkluzionit/rekomandimit; të përqëndruar rreth ngjarjeve më të rëndësishme të cilat ekspozojnë strukturën/subjektin ndaj riskut, si dhe opinion për çdo sistem të vlerësuar. Në raportet e përgatitura nga grupet e auditimit nuk jepej opinion mbi vlerësimin dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

Vërehet se raportet e hartuara, duhet të paraqesin më drejt përshkrimet pozitive dhe negative të proceseve/procedurave e sistemeve të audituara, në referencë me çfarë mangësie konstatohet konkretisht, në mënyrë që ky vlerësim përfundimtar mbi përshtatshmërinë, efektivitetin e sistemeve të kontroleve të jetë sa më i dobishëm.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se, gjetjet megjithëse evidentohen nga audituesit, ato nuk argumentohen në mënyrë të detajuar në raport, i cili duhet t’i komunikohet drejtuesit të subjektit të audituar në mënyrë objektive, të qartë dhe në kohë.

Gjithashtu, të gjitha gjetjet duhet të mbështeten me dokumentacionin justifikues dhe të bëhen pjesë e inventarit të dosjes. Në raportet e auditimit, ka disa trajtime, si çështje më vehte që prekin funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në raport me zbatimin e rregulloreve të menaxhimit të aktiveve nga strukturat dhe punonjësit e ngarkuar, apo procedurat e regjistrimit të pronave dhe ambienteve të dhëna me qera nga UAMD, etj, por këtu nënvizojmë se këto vlerësime duhet të bëhen më të plota dhe të përfshijnë të gjithë komponentët e kontrollit të brendshëm, të bazohen në analizën e riskut, mbi përcaktimin e faktorëve kryesorë në rezultatet e vlerësimit të tij, sipas kriterëve për vlerësimin e nivelit të riskut (I lartë, I mesëm dhe I ulët).

Nga grupi i auditimit vlerësohet se Projekt Raportet apo Raportet Përfundimtare të hartuara për angazhimet e auditimit në përmbajtjen e tyre:

- a) Nuk respektonin strukturën e raporteve miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.4, datë 01.01.2021 “Për miratimin e disa shtesave e ndryshimeve në Manualin e Auditimit të Brendshëm miratuar me urdhër nr. 100, datë 25.10.2016”;
- b) respektonin afatin kohor për përgatitjen dhe përcjelljen e Projekt Raportit, në respektim të përcaktimeve në standardin 2240 IIA sipas të cilit: “*Komunikimet duhet të jenë të sakta, objektive, të qarta, konçize, konstruktive, të plota dhe në kohë*”. Në interpretim të këtij standardi komunikimet e kryera në kohë janë të volitshëm dhe të përshtatshëm në varësi të rëndësisë së çështjes, për të ndihmuar menaxhimin të marrë masat e duhura korrigjuese;
- c) Përmbledhja ekzekutive, në përmbajtje nuk ka informacion të plotë për mangësitë e evidentuara, rekomandimet më të rëndësishme të adresuara, por duhet plotësuar me opinionin e përgjithshëm për funksionimin e sistemit të kontroleve të brendshme të vendosura të shprehur me terma sa më konkretë, si dhe me nivelin e riskut të subjektit në përfundim të auditimit për të vlerësuar progresin e tij ndërmjet dy auditimeve;
- d) vlerësimi i komponentëve të kontrollit të brendshëm, në strukturat e audituara, nuk trajtohej në raporte nëpërmjet analizimit të komponentëve të tij (megjithëse dokumentohen elementë të kësaj analize). Analiza e këtyre komponentëve (mjedisi i kontrollit, menaxhimi i riskut, veprimtaritë e kontrollit, informacioni dhe komunikimi, monitorimi), ndihmon audituesit të konkludojnë dhe shprehin opinionin e përgjithshëm

lidhur me mjaftueshmërinë, efektivitetin dhe efikasitetin e funksionimit të sistemit të kontrolleve të brendshme të vendosura nga subjekti i audituar;

- e) zbatimi i rekomandimeve të adresuara në auditimet e mëparshme, megjithëse nuk është parashikuar si një ndër drejtimet e Programit në çdo angazhim auditimi, ishte trajtuar në përmbajtje të Raporteve të hartuara si çështje e veçantë “Zbatimi i rekomandimeve të mëparshme”.

Standartet e AB përcaktojnë që rekomandimet duhen referuar sipas klasifikimit në planveprim, të cilat të evidentohen sipas natyrës së tyre dhe sipas gjetjeve në përputhje me karakteristikat e strukturës së audituar, duke i adresuar gjetjet sipas rëndësisë, për të argumentuar se zbatimi i tyre do të ndihmojë menaxhimin në arritjen e objektivave, dhe përmirësuar sistemet e kontrollit të brendshëm.

Bazuar në përcaktimet e pikës 4.1.11 të Manualit të AB, grupi i auditimit ka dërguar Projekt Raportin pranë subjektit të audituar, por nuk është hartuar plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve (sipas (Formatit standard 10) dhe ndarja e rekomandimeve sipas nivelit të rëndësisë dhe afatit të zbatimit të tyre.

Bazuar në pikën 4.1.12 të Manualit të Auditimit të Brendshëm, kërkohet që audituesit kanë detyrimin që pas afatit 30 ditëve nga data e dërgimit të raportit final, me marrjen ose jo të planveprimit nga subjekti i audituar, duhet të paraqesin tek titullari i institucionit “Memon”, duke u shprehur që *nga menaxhimi i subjektit të audituar është reaguar (ose jo) me plotësimin e plan-veprimit në lidhje me masat e marra për zbatimin e rekomandimeve* dhe ku duhet të paraqiten konkluzionet dhe rezultatet pas vlerësimit të sistemeve të audituara, së bashku me gjetjet dhe rekomandimet e adresuara.

Për sa më sipër, grupi i vlerësimit, konsideron raportet e auditimit se nuk e kanë pasqyruar objektivisht informacionin për problemet kryesore të trajtuar sipas rastit, ato duhet të ishin më konçize dhe të mbështesnin analizën në evidenca të mbledhura gjatë punës në terren, si dhe evadimi i materialeve të auditimit nuk është realizuar brenda afateve kohore të përcaktuara në MAB

Nga shqyrtimi i dokumentacionit përkatës, konstatohet se raportet përfundimtare të auditimit, në përfundim të vlerësimeve të sistemeve përkatëse, përmbajnë adresimin e rekomandimeve, të cilat për periudhën objekt vlerësimi paraqiten të ndara:

	Rekomandim e gjithsej	Rekomandimet e dhëna sipas prioriteteve				
		Për përmirësimin e sistemeve	Për përmirësimin kuadrit ligjor	Të karakterit organizativ	Për arkëtim	Të tjera
2020	0	0	0	0	0	0
2021	5	5	0	0	0	0

Tabela 2. Të dhëna mbi rekomandimet e viteve 2021-2022

Kryesisht rekomandimet i referohen gjetjeve të konstatuara për përmirësimin e sistemeve përkatëse, uljen e nivelit të riskut në këto sisteme dhe dhënien e këshillave për zgjidhje që mundësojnë parandalimin e rasteve të shkeljeve në të ardhmen.

Rezulton se nga subjektet e audituara nuk janë shprehur opinione/kundërshtime mbi gjetjet dhe rekomandimet e auditimit, për arsye se pala e audituar nuk ka patur pretendime mbi gjetjet dhe rekomandimet e auditimit.

Sa trajtuar më sipër grupi i vlerësimit rekomandon:

Rekomandim: Audituesit e Brendshëm në çdo Projekt Raport dhe Raport Përfundimtar të hartuar për komunikimin e rezultateve të auditimit duhet të përfshijnë, në përmbajtjen e rubrikave pjesë e

strukturës së tyre, informacionin e parashikuar në MAB. Raportet duhet të jenë të qartë, të shmangin përshkrimet e pa nevojshme, të pasqyrojnë vlerësimin mbi funksionimin e sistemit të kontrolleve të brendshëm të vendosura dhe rezultatet e vlerësimit të riskut.

Rekomandim: Audituesit e Brendshëm, në funksion të orientimit të subjektit të audituar drejt përmirësimeve sa më efikente, të adresojnë rekomandime me terma të qartë, konkretë dhe të zbatueshëm dhe të kërkojnë plotësimin dhe miratimin e planveprimit për zbatimin e rekomandimeve nga ky subjekt me qëllim monitorimin e trajtimit të rezultateve të komunikuar.

Rekomandim: Audituesit e Brendshëm, në përmbajtjen e Memo-s informuese të hartuar pas marrjes së planveprimit nga subjekti i audituar për çdo angazhim auditimi, të pasqyrojë një përmbledhje të shkurtër të raportit përfundimtar, me vlerësimet, konkluzionet, opinionin e përgjithshëm për funksionimin e sistemit të kontrolleve të brendshme të vendosura si dhe rekomandimet e adresuara, për përmirësimin e këtij sistemi.

Opinion i grupit të vlerësimit për përputhshmërinë e veprimtarisë audituese me përcaktimet në Manualin e Auditimit të Brendshëm dhe plotësimin e kriterëve të Standardit 2400, thekson faktin se:

Spektori i Auditimit të Brendshëm në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës funksionon:

-  - E kuqe - në mospërputhje të plotë me standardin.

• STANDARD 2500 - MONITORIMI I PROGRESIT

Drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm duhet të vendosë dhe të mirëmbajë një sistem monitorimi për zbatimin e rekomandimeve të adresuara në subjektet e audituara dhe të komunikuar menaxhimit të lartë.

Në interpretim të këtij standardi veprimtaria e Spektorit të Auditimit të Brendshëm nuk duhet të kufizohet vetëm në paraqitjen e propozimeve dhe adresimin e rekomandimeve, por duhet të konsiderojë si tregues të rëndësishëm dhe shkallën e zbatimit të tyre.

Nga rishikimi i dosjeve të përzgjedhura, vërehet se verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të mëparshme nuk parashikohej si një nga drejtimet e Programit në auditimin e radhës në përputhje me përcaktimet në standardin 2500 IIA sipas të cilit: “Drejtuesi i auditimit të brendshëm duhet të vendosë dhe të mirëmbajë një sistem për monitorimin e trajtimit të rezultateve të komunikuar menaxhimit”, por nuk trajtohej si çështje e veçantë edhe në Raportet e hartuara si një nga mënyrat për monitorimin e këtij progresi të parashikuara në seksionin 4.1.13.2 “Raportimi i ndjekjes së rekomandimeve”, të MAB, të ndryshuar.

Nga ana e drejtuesve të strukturave të audituara, rekomandimet e lëna nga auditimi, janë pranuar në zbatim të kërkesave të ligjit 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” neni 12, shkronja “d” dhe pikës 4.1.13.1 të Manualit të AB, por subjektet e audituara nuk kanë hartuar, miratuar dhe dërguar, brenda periudhës 30-ditore tek NJAB, Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të adresuara. Në këtë kuadër dhe NJAB në adresë të subjekteve/strukturave të audituara nuk ka përcjellë shkresën për marrje të informacionit mbi progresin dhe ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna në Raportin Përfundimtar të Auditimit. Subjektet/strukturat e audituara, konform pikës 4.1.13.3 të MAB. Pra këto subjekte nuk kanë raportuar e informuar në mënyrë periodike pranë NJAB, për progresin që është bërë për zbatimin e rekomandimeve të lëna, jo më vonë se 10 ditë nga plotësimi i afateve për zbatimin e tyre.

Projekt Raportet e Raportet Përfundimtare të hartuara për çdo angazhim auditimi përcilleshin në subjektin e audituar shoqëruar me shkresa përcjellëse në respektim të përcaktimeve në seksionin 4.1.12 “Raportet e auditimit dhe plotësimi i planveprimit nga njësia e audituar”.

Në përmbajtje të shkresave përcjellëse të raporteve përfundimtare të dërguara në subjektin e audituar:

- nuk njoftohej përcjellja e Planveprimit të sugjeruar të zbatimit të rekomandimeve (dokument i parashikuar në fazën e dërgimit të Projekt Raportit sipas skemës së procesit të auditimit Manuali i Auditimit të Brendshëm fq.82);
- nuk specifikohet detyrimi ligjor i hartimit dhe miratimit nga titullari i subjektit të audituar i planveprimit në respektim të përcaktimeve në germën d), të nenit 12, të ligjit 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, sipas të cilit titullarët e njësive publike janë përgjegjës për:

“d) hartimin, miratimin dhe ndjekjen e planit të veprimit, për zbatimin e rekomandimeve të lëna në përfundim të procedurave të auditimit nga njësia e auditimit të brendshëm dhe/ose në përfundim të procedurave të vlerësimit të cilësisë së auditimit nga struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm, brenda 30 ditëve nga data e dorëzimit të raportit përfundimtar”.

Bazuar në përcaktimet e pikës iv) të germës ç), të nenit 14 të ligjit nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe në Manualin e AB, pika 4.1.13.3 “Përgjegjësia e njësisë për të zbatuar rekomandimet e AB”, gjatë vitit nuk ka kryer misionin për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna.

Nga intervistat e kryera në Universitetin e Durrësit lidhur me vlerësimin e profesionalizmit të audituesve të NJAB, konfirmohet se audituesit e brendshëm kanë patur komunikim të vazhdueshëm me subjektet e audituara. Në këtë kuadër, nga subjektet njëhej detyrimi i përcaktuar në shkronjëm “d”, të nenit 12, të ligjit 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” lidhur me hartimin e zbatimit të planveprimit për rekomandimet e dhëna.

Gjatë periudhës së vlerësimit, të gjitha subjektet/strukturat e audituara kanë pranuar rekomandimet e adresuara, por pavarësisht se nuk kanë përcjellë prane NJAB planin e veprimit, menaxhimi i lartë i ka kuptuar përgjegjësitë e tij ligjore për të eliminuar riskun, që mund të vijë nga efekti i mos zbatimit të rekomandimeve, me qëllim për të ndërmarrë në të ardhmen një proces të përkallëzuar nga ana e Drejtuesit të NJAB.

Sa trajtuar më sipër grupi i vlerësimit rekomandon:

Rekomandim: Sektori i Auditimit të Brendshëm të komunikojë dhe të kërkojë informacione periodike nga subjektet e audituara në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të adresuara, me qëllim që të sigurohet se veprimet korrigjuese të rekomanduara janë efikase, ndihmojnë në minimizimin e risqeve në nivele të pranueshme dhe forcimin e sistemit të kontrollit të brendshëm duke respektuar afatet e raportimit për masat e marra.

Rekomandim: Audituesit e Brendshëm, të zhvillojnë procedura për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të adresuara në auditimet e mëparshme, duke i përfshirë si drejtim auditimi të veçantë në çdo program angazhim auditimi. Në raportet e hartuara të pasqyrojnë në mënyrë të plotë veprimet e argumentuara të kryera nga subjekti për çdo rekomandim, si dhe të përcaktojnë me gjykim profesional statusin e rekomandimit në momentin e verifikimit (i zbatuar, në proces zbatimi, apo i pa zbatuar), duke e mbështetur procedurën në dokumentacion justifikues mbështetës.

Opinion i grupit të vlerësimit për përputhshmërinë e veprimtarisë audituese me përcaktimet në Manualin e Auditimit të Brendshëm dhe plotësimin e kriterëve të Standardit 2500, thekson faktin se:

Sektori i Auditimit të Brendshëm në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës funksionon:


 - Portokalli - në përputhje me disa fusha me standardin, por kërkohen përmirësime të domosdoshme në fushat ku janë adresuar rekomandime.

IV. OPINION I PËRGJITHSHËM

Opinion i grupit të vlerësimit për përputhshmërinë e veprimtarisë së Sektorit të Auditimit të Brendshëm në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës me:

- përcaktimet në Manualin e Auditimit të Brendshëm dhe;
- parimet e parashikuara në grupin e standardeve të shqyrtuara paraqitet si më poshtë:


Vlerësimi për Standardet Kryesore

Standardi 1100 “Pavarësia dhe objektiviteti”		E gjelbër
Standardi 1200 “Aftësia dhe kujdesi i duhur profesional”		E gjelbër
Standardi 2000 “Menaxhimi i veprimtarisë së auditimit brendshëm”		E verdhë
Standardi 2200 “Planifikimi i angazhimit”		E verdhë
Standardi 2300 “Kryerja e Angazhimit”		E gjelbër

Vlerësimi për Standardet Dytësore

Standardi 1000 “Qëllimi, Autoriteti dhe përgjegjësia”		Portokalli
Standard 1300 “Sigurimi i cilësisë dhe programi i përmirësimit”		E kuqe
Standard 2100 “Natyra e Punës”		Portokalli
Standardi 2400 “Komunikimi i rezultateve”		E kuqe
Standard 2500 “Monitorimi i progresit”		Portokalli

Sektori i Auditimit të Brendshëm në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës funksionon:

-  - në përputhje të pjesshme me standardet ndërkombëtare për praktikat profesionale të auditimit të brendshëm, por përmirësimet janë të nevojshme në fushat sipas të cilave janë adresuar rekomandime.

Projekt-Raporti hartohet në 3(tre) kopje, dy prej të cilave dërgohen në Sektorin Auditimit të Brendshëm në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës.

Grupi i vlerësimit

Albana GJINOPULLI

Nevila PICIRI

Sokol BUNDO

I. ANEKS 1: METODOLOGJIA

1. Metoda e përdorur

Raporti për vlerësimin e jashtëm të cilësisë është hartuar duke u bazuar në shqyrtimin e grup standardeve (atributive dhe të performancës) të “Metodologjisë së Vlerësimit të Jashtëm të Cilësisë për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, e miratuar me urdhër të Ministrit të Financave nr. 22, datë 06.03.2017.

Grupi i vlerësimit e realizoi këtë angazhim nëpërmjet - *Metodës së përdorimit të pyetësorëve dhe konfirmimit*, të përcaktuar në Kapitullin V të Manualit të Auditimit të Brendshëm. Metoda e përzgjedhur u vlerësua nga grupi si e përshtatshme dhe efektive për këtë vlerësim sepse informacioni i siguruar është i drejtpërdrejtë dhe i jep mundësi grupit të krijojë siguri në një nivel të pranueshëm mbi funksionimin e kësaj njësie auditimi në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm të pranuar.

2. Vlerësimi i përputhshmërisë së veprimtarisë audituese me përcaktimet në Manualin e Auditimit të Brendshëm dhe grup standardet e shqyrtuara.

Përputhshmëria e veprimtarisë së njësisë së auditimit të brendshëm me standardet e shqyrtuara sipas metodologjisë së përdorur paraqitet nga katër rezultate të mundshme, të ilustruar me ngjyra:

-  e gjelbër, përputhje e plotë me standardin;
-  e verdhë, përputhje e pjesshme me standardin, por përmirësimi është i nevojshëm në fusha të caktuara;
-  portokalli, përputhje me standardin por në disa fusha kërkohen përmirësime kritike (të domosdoshme);
-  e kuqe, mospërputhje e plotë me standardin.

ANEKS 2: BURIMET E INFORMACIONIT

Mbështetur në shkresën nr.12875/1, datë 01.07.2022 “Program për vlerësimin e jashtëm të cilësisë së njësive të auditimit të brendshëm në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës”, grupi i vlerësimit ka mbledhur informacionin për hartimin e raportit të vlerësimit duke analizuar burimet e mëposhtme:

1. Plani Strategjik dhe Vjetor 2020-2022 i veprimtarisë së auditimit të brendshëm në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës është dërguar në DH/AB në mënyrë elektronike.
2. Plani Strategjik dhe Vjetor 2021-2023 i veprimtarisë së auditimit të brendshëm në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës është dërguar në DH/AB në mënyrë elektronike.
3. Raporti i veprimtarisë së auditimit të brendshëm për vitin 2020 është dërguar në DH/AB në mënyrë elektronike.
4. Raporti i veprimtarisë së auditimit të brendshëm për vitin 2021. miratuar nga Bordi me Vendim nr.17/1, datë 24.03.2022 dhe është dërguar zyrtarisht në DH/AB në MFE nr.275/1, datë 24.03.2022.
5. Intervistat e realizuara me: Rektoren e Universitetit dhe Kryetaren e Bordit të Administrimit të Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës, si dhe Drejtuesin e NJAB e audituesit të brendshëm, të këtij Universiteti.
6. Dosjet e angazhimeve të auditimit:

Viti 2020:

- Drejtoria e Investimeve dhe Prokurimeve Publike

Viti 2021:

- Drejtoria e Menaxhimit Financiar (paga, shpenzime, vendimet gjygjësore);
- Drejtoria e Menaxhimit Financiar (menaxhimi i aktiveve);
- Drejtoria e Investimeve Publike (pronat dhe kontratat e qerasë);
- Auditim mbi procedurat e dhënies së bursave 2019-2020;
- Auditim mbi zbatimin e vendimeve, urdhërave dhe shkresave të Bordit të Administrimit.

ANEKS 3: LISTA E INTERVISTAVE TË ZHVILLUARA

Nr.	Funksioni i të intervistuarit	Institucioni	Qëllimi i intervistës
1.	Rektoren e Universitetit	Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës	Roli i auditimit të brendshëm si shtues vlere në institucion.
2.	Kryetaren e Bordit të Administrimit të Universitetit	Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës	Roli i auditimit të brendshëm si shtues vlere në institucion.
3.	Drejtuesin dhe audituesit e brendshëm të NJAB	Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës	Evidentimin e risqeve me qëllim zbulimin e rasteve abuzive dhe risqeve për mashtrim.

